



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 5

Tiranë – E premte, 24 janar 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 1/2020, datë 20.1.2020	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 601
Vendim i Kuvendit nr. 2/2020, datë 20.1.2020	Për zgjedhjen e zotit Artur Metani Inspektor i Lartë i Drejtësisë..... 601
Dekret i Presidentit nr. 11417, datë 17.1.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 15.1.2020	Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara..... 602
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 22.1.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 856, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, të pasurisë nr. 1/586/5, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, për t’u përdorur si seli e Sekretariatit të Fondit të Ballkanit Perëndimor”..... 603
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 22.1.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 886, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit”..... 604
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 22.1.2020	Për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror..... 634

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 22.1.2020	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj.....	638
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 22.1.2020	Për miratimin e tarifave për shërbimet elektronike të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.....	665
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 22.1.2020	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “SV Mega” sh.p.k., si qiramarrës, për pasuritë shtetërore nr. 1/82, me sipërfaqe totale 554 m ² dhe nr. 1/83, truall i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 4246 m ² , zona kadastrale 2646, pjesë e stacionit hekurudhor të Librazhdit, e përbërë nga dy pasuri, në administrim të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës.....	665
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 38, datë 22.1.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘By-Pass Vlorë’ (shtesa)”.....	671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 22.1.2020	Për shfuqizimin e vendimit nr. 452, datë 27.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e varrezave private në Njësinë Administrative ‘Paskuqan’, qarku Tiranë”.....	675
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 40, datë 22.1.2020	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 56/50, zona kadastrale 2946, Bashkia Përmet.....	675
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 22.1.2020	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020.....	680
Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 14, datë 16.1.2020	Për shpalljen e “Thirrjes së pestë” në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.....	685
Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 18, datë 17.1.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të arsimit të mesëm të lartë, “SAADI”, Tiranë.....	687
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 2, datë 17.1.2020	Për disa ndryshime në rregulloren “Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurave për administrimin e tij”.....	688
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 810/1, datë 21.1.2020	Për shpronësim, për interes publik, për pasurinë e paluajtshme pronë private, që preket nga projekti “Sistemi rrugësh, blloku Goricë”, Bashkia Pogradec.....	691
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 811/1, datë 21.1.2020	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Arbrit” (shtesa).....	692

Kërkesë e Ministrisë së
Infrastrukturës dhe Energjisë
nr. 812, datë 21.1.2020

Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të
paluajtshme, pronë private, të llojit “truall” dhe “ndërtesë banimi”,
që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi ish-parkut Kuçovë”...

695

Korrigjim gabimi në vendimin nr. 112, datë 8.7.2016, “Për
përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit
universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve
për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, botuar në Fletoren
Zyrtare nr. 139, datë 27.7.2016.....

697

Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Muhamed
Virjoni.....

700



VENDIM
Nr. 1/2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 86/2017
“PËRCAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pikat 2, 3 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet këto ndryshime:

I. Deputetja Milva Ekonomi caktohet kryetare në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

II. Deputetja Mirela Kumbaro caktohet zëvendëskryetare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.1.2020.

VENDIM
Nr. 2/2020

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ARTUR
METANI INSPEKTOR I LARTË
I DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 201, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Artur Metani zgjidhet Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 20.1.2020.

DEKRET
Nr. 11417, datë 17.1.2020

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Artur Ramadan Drinaj
2. Donika Hasan Müller (Mezini)
3. Radmila (Radmilla) Urosh Matanović (Tatiçaj/Zlaticanin)
4. Hristan Igor Matanović
5. Desara Igor Matanović
6. Xhenti Aleko Kapaj
7. Amarilda Kadri Häusler (Bytyçi/Bytyci)
8. Eduard Ismail Shehi
9. Ilfete Haxhi Domi (Imeraj)
10. Harjeta Hasan Pinkas (Shingjini)
11. Tilma Tim Zhupani
12. Rudina Refat Fritsche (Doku)
13. Nikolin Pjeter Bilaçi
14. Snežana (Snezhana) Jovan Krstović (Davodović)
15. Suela Abdulla Metz (Cano)
16. Klaudia Anton Bytyçi (Bytyci)



17. Jetmir Shyqyri Zeneli
18. Missar Bëatjer
19. Altin Sheref Derraj
20. Esmeralda Gramoz Birçaj (Bircaj)
21. Lenica Nita Birçaj (Bircaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr.26, datë 15.1.2020

**PËR KRYERJEN E AKTEKSPERTIZËS
SË THELLUAR NË NDËRTESAT E
DËMTUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të nenit 34, të ligjit nr.97/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë aktekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në aktkonstatimet ose aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit.

2. Aktekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e opinionit. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.

3. Kryerja e aktekspertizës së thelluar për objektet, publike ose private, që janë klasifikuar me

shkallë dëmtueshmërie DS4 dhe DS5, bëhet sipas tarifave:

- a) Dokumentimi gjeometrik dhe teknik për objektet pa dokumentacion teknik 150 lekë/m²;
- b) Aktekspertiza 40 lekë/m²;
- c) Analiza strukturore e thelluar përfshin azhurnimin gjeometrik dhe teknik:
 - i. Provat laboratorike 200 lekë/m²;
 - ii. Studimit të thelluar 300 lekë/m²;
- ç) Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse 200 lekë/m².

4. Për objektet pa projekt teknik të realizohet dokumentimi gjeometrik dhe teknik i strukturës së objektit, që përfshin realizimin e:

- a) detajimit gjeometrik, planeve të strukturave dhe të dimensionimeve gjeometrike të elementeve strukturale;
- b) projektimit simulues;
- c) studimit gjeologjik dhe projektit simulues të themeleve.

5. Aktekspertiza e thelluar përfshin, si më poshtë vijon:

- a) Mbledhjen e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik për objektin, si:
 - i. projektin arkitektonik;
 - ii. projektin konstruktiv;
 - iii. lejet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse;
 - iv. studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;
 - v. studimin sizmik;
 - vi. procesverbalet e punimeve të maskuara;
 - vii. raportin e llogaritjes së strukturës.

b) Evidentimin e ndryshimeve gjeometrike në strukturën e objektit gjatë kohës së shfrytëzimit;

- c) Përditësimin gjeometrik të strukturës;
- ç) Mbledhjen e dokumentacionit të zbatimit;
- d) Katalogimin e dëmtimeve në objekt;
- dh) Gjykimin inxhinierik në bazë të raportit të llogaritjes së strukturës, të dokumentacionit të zbatimit dhe të shkallës së dëmtimit;

e) Konkluzionet për origjinën dhe shkallën e dëmtimit të objektit dhe përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga aktekspertizat e mëparshme.

6. Analiza e thelluar përfshin:

- a) studimin e dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij vendimi;
- b) studimin e strukturave sipas përcaktimeve të SSH EN 1998-3:2005:
 - i. Studimi gjeometrik;



- ii. Studimi i materialit;
- iii. Studimi i detajimeve.

c) studimin e strukturave, që do të shoqërohet me kryerjen e testeve, me shkatërrim dhe pa shkatërrim, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të;

ç) realizimin e studimit gjeologjik;

d) realizimin e studimit sizmik;

dh) në mungesë të projekteve, do të realizojë projektim simulues bazuar në kushtet teknike në fuqi;

e) evidentimin dhe katalogimin e dëmtimeve;

ë) analizën lineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, të përshtatshme për tipin e strukturës. Ngarkimi sizmik të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005 ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të;

f) analizën jolineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, sipas njërës nga metodat e përshtatshme për tipin e strukturës që po analizohet;

g) konkluzionin për performancën e godinës, sipas metodologjisë bazuar në standardin shqiptar për sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me standardin shqiptar për sizmicitetin;

gj) rekomandimet për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me to.

7. Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse hartohet në bazë të kushteve teknike të projektimit në fuqi dhe të standardeve evropiane të transpozuara. Hartimi i projektit mbështetet në rekomandimet e analizës së thelluar dhe përfshin të gjitha detajet e nevojshme për ndërhyrje si dhe metodologjinë e aplikimit.

8. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Instituti i Ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 28, datë 22.1.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 856, DATË 10.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK, PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, TË PASURISË NR. 1/586/5, ZONA KADASTRALE NR. 8380, TIRANË, PËR T’U PËRDORUR SI SELI E SEKRETARIATIT TË FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 2, të marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, ratifikuar me ligjin nr. 44/2018, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 856, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, afati “... dhjetor 2014 – dhjetor 2019 ...” zëvendësohet me “... dhjetor 2014 – dhjetor 2024.”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 30, date 22.1.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 886, DATË 3.11.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS PËRFUNDIMTARE TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE
NË PËRDORIM TË BASHKISË BELSH,
TË QARKUT TË ELBASANIT”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 886, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të dhënat e pronës me numër rendor 361 (treqind e gjashtëdhjetë e një) zëvendësohen me të dhënat e përcaktuara në formularët, gjithsej 3 (tri) fletë, dhe planvendosjet, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen bashkia Belsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni : Bashkia Belsh

Fusha e perdorimit te Prones: Bujqësi dhe Ushqim

Identifikoi: Mirela ELEZI SPECIALIST

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Halim TAFANI PERGJ. KADASTRES

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Arif TAFANI (Kryetari i Bashkisë)

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

A			B				C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
361	3272		Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	336296	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-A)	64/8	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	9603	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-A)	64/15	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	2557	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-A)	66	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	663	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-A)	69/29	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	571	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-A)	70	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	614	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-A)	71/17	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	11491	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	
	3272 (45-B)	81/18	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	4288	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh	




3272 (45-B)	82	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	10379	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-B)	100/5	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	1686	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-B)	122	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	142700	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-D)	131/3	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	2157	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-D)	133	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	3678	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-D)	134/4	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	47446	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-D)	137/21	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	576	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-D)	137/22	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	2090	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-D)	137/23	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	13965	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-C)	148	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	1915	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-C)	149	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	1285	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-C)	153	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	6754	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh
3272 (45-C)	154	Ranisht		Ranisht Fshati Seferan	4372	Ranisht	Bashkia Belsh	Bashkia Belsh



PLAN VENDOSJE E PASURISE Nr. 122 Fshati SEFERAN BASHKIA BELSH

z.k 3272

Shk. 1: 2500



Shënim : Pasuria nr.122 me sipërfaqe 14 2 700 m² e llojit "ranishtë- p.f.", pronë shteti.


KRYETARI I BASHKISË


APR TAFANI


PUNQI

Halim TAFANI


(Në mungesë me porosi)
Mustafa ÇARÇIU























KONFIRMOI


KRYETARI I BASHKISË

(Në mungesë me porosi)

Sekret. I Përgjithshëm

Mustafa ÇARÇIU

Mustafa ÇARÇIU





KUFITARET :


EWIS BAKTI


OWD 15 DAY


4226


































VENDIM
Nr. 31, datë 22.1.2020

**PËR ORGANIZIMIN, PËRBËRJEN,
FUNKSIONIMIN DHE STATUSIN E
AUTORITETIT TË KONTROLLIT
SHTETËROR TË EKSPORTEVE,
PËRCAKTIMIN E AFATEVE, TË
MËNYRËS DHE TË PROCEDURËS PËR
SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT
DHE TË MARRJES SË MENDIMIT NGA
INSTITUCIONET E TJERA TË
PËRFSHIRA NË TRANSFERIMET
NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE TË
KONTROLLUARA, SI DHE
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR
LËSHIMIN E GARANCIVE DHE
KRYERJEN E KONTROLLIT
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 4, dhe 35, pika 8, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim synon miratimin e:

a) statusit, të organizimit, të përbërjes e të funksionimit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;

b) afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara;

c) procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror.

**II. STATUSI, ORGANIZIMI, PËRBËRJA
DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETIT TË
KONTROLLIT SHTETËROR TË
EKSPORTEVE**

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (këtu e në vijim AKSHE) është institucion qendror,

me statusin e personit juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Mbrojtjes (këtu e në vijim “ministri”), me seli në Tiranë.

3. AKSHE-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

4. AKSHE-ja mund të marrë dhurime e financime nga organizma, brenda dhe jashtë vendit, për të cilat nuk ka detyrim për t'i kthyer e që hyjnë në buxhetin e saj dhe përdoren në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë.

5. AKSHE-ja është përgjegjëse për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake, të artikujve dhe të teknologjive me përdorim të dyfishtë.

6. AKSHE-ja mund të nënshkruajë, sipas ligjit për prokurimin publik, kontrata me persona, fizikë e juridikë, duke pasur si objekt kryerjen e shërbimeve të konsulencës së nevojshme për realizimin e objektivave brenda fushës së përgjegjësisë.

7. AKSHE-ja ka këto përgjegjësi:

a) të sigurojë regjistrimin e personave, fizikë e juridikë, përfshirë edhe autoritetet publike, për kryerjen e veprimtarive me mallra ushtarake;

b) të organizojë punën për licencimin e veprimtarive të transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara dhe pajisjen e personave të interesuar me licenca, certifikata regjistrimi, certifikata ndërkombëtare të importit, certifikata të shpërndarjes së mallit, si dhe dokumente të tjera të parashikuara në legjislacionin përkatës në këtë fushë;

c) të zhvillojë procesin e kontrollit të të gjitha fazave të licencimit, të regjistrimit, të njoftimit, të livrimit, të paslivrimit, si dhe, sipas rastit, në të gjitha fazat e paralicencimit.

8. AKSHE-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në nivel qendror, në formën e drejtorisë së përgjithshme.

9. AKSHE-ja drejtohet nga kryetari, i cili përgjigjet për zhvillimin e veprimtarisë së këtij autoriteti, në përputhje me këtë vendim dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

10. Kryetari i AKSHE-së, përveç detyrave të tjera:



a) siguron drejtimin e veprimtarisë së autoritetit për licencimin e veprimtarive me mallra ushtarake dhe mallra e teknologji me përdorim të dyfishtë;

b) bashkërendon veprimtarinë e autoritetit me institucione të tjera të fushës;

c) nxjerr urdhra e udhëzime, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Urdhrat e udhëzimet e kryetarit bëhen të njohura për publikun dhe personat e interesuar, nëpërmjet instrumenteve të përcaktuara në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe të sjelljes së personelit të AKSHE-së.

11. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i kryetarit të AKSHE-së bëhen nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

12. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i nëpunësve të AKSHE-së bëhen nga ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e kryetarit.

13. Marrëdhëniet e punës së kryetarit, të nëpunësve dhe të punonjësve të AKSHE-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

14. Struktura dhe organika e AKSHE-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të ministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

15. AKSHE-ja, për zbatimin e detyrimeve e të përgjegjësive të përcaktuara në legjislacionin për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, kryen edhe detyrat, si më poshtë vijnë:

a) asiston Ministrinë e Mbrojtjes për hartimin e politikave dhe të strategjisë kombëtare në fushën e kontrollit të veprimtarive me mallrat e kontrolluara, duke mbajtur në konsideratë harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian dhe me detyrimet ndërkombëtare, të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe konventat ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) bashkërendon sistemin kombëtar të kontrollit të veprimtarive me mallrat e kontrolluara dhe zhvillon veprimtari periodike për informimin dhe përgatitjen e institucioneve të tjera shtetërore, që kanë kompetenca në kontrollin e transferimeve ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara;

c) nënshkruan, sipas ligjit, marrëveshje, urdhra, memorandumë, protokolle bashkëpunimi, programe të përbashkëta e veprimtari me institucione dhe autoritete të tjera shtetërore, vendëse apo të huaja;

ç) raporton, në mënyrë periodike, te ministri i Mbrojtjes, për veprimtarinë e saj;

d) përgatit raportin vjetor për raportimin e ministrit të Mbrojtjes në Këshillin e Ministrave, mbi zhvillimet thelbësore vjetore në fushën e kontrollit të transferimeve ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara. Raporti vjetor duhet të përmbajë:

i. raportin e punës së AKSHE-së për vitin e mëparshëm;

ii. programin vjetor të punës për vitin në vazhdim;

iii. realizimet e licencave të lëshuara për transferimin ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara.

Ky raport përbën informacion të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi, për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;

dh) përgatit raport vjetor të hapur për publikun dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar për të drejtën e informimit;

e) asiston Ministrinë e Mbrojtjes për hartimin e projektakteve, në përputhje me fushën e përgjegjësisë;

ë) miraton norma metodologjike, mekanizma, procedura dhe udhëzime të nevojshme për zbatimin e regjimit të kontrollit të transferimeve ndërkombëtare me mallra të kontrolluara;

f) regjistron personat fizikë e juridikë, përfshirë edhe autoritetet publike, për kryerjen e transferimeve ndërkombëtare me mallra ushtarake;

g) licencon veprimtaritë e eksportit, të eksportit të përkohshëm, të importit, të importit të përkohshëm, të riekportit, të ndërmjetësimit, të transitit ose të *transship*-it nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, asistencës teknike, transferimeve të *software*-ve dhe çdo transferim tjetër, jashtë apo brenda këtij territori, në të cilën



janë përfshirë subjekte të ndryshme dhe mallrat e kontrolluara;

gj) aprovon me kushte, refuzon, ndryshon, kufizon, revokon apo shfuqizon licenca, autorizime apo certifikata të lëshuara;

h) kryen veprimtari kontrolli në të gjitha fazat e licencimit, të autorizimit, të regjistrimit, të certifikimit, të njofimit, të livrimit, të postlivrimit, si dhe, sipas rastit, në të gjitha fazat e paralicencimit;

i) ushtron veprimtaritë e kontrollit në të gjitha fazat e procesit, nëpërmjet specialistëve të punësuar pranë AKSHE-së ose nëpërmjet ekspertëve të jashtëm ose institucioneve akademike, në rastet kur nevojitet ekspertizë teknike për klasifikimin e mallrave ushtarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë. Shpenzimet që mund të nevojiten për një ekspertizë teknike të specializuar në laboratorë, institute kërkimi ose institucione të tjera të specializuara, për klasifikimin e mallrave ushtarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë, mbulohen nga subjekti, privat apo publik, i interesuar për klasifikimin e këtyre mallrave;

j) shkëmben informacion, të përgjithshëm dhe të veçantë, për transferimet dhe refuzimet e licencave të eksportit, në kuadër të regjimeve ndërkombëtare të parandalimit të mospërhapjes së armëve dhe të kontrollit të transferimeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

k) bashkëpunon, sipas kompetencave, në zhvillimin e veprimtarive të monitorimit dhe të zbatimit të embargove e të regjimeve shtrënguese, për eksportet e mallrave të kontrolluara dhe të detyrimeve, të cilat rrjedhin nga zbatimi i embargove për transferimin e mallrave të kontrolluara, të vendosura nëpërmjet një rezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të një rregulloreje të miratuar nga BE-ja, të një vendimi të OSBE-së, të vendimit të disa shteteve të NATO-s ose në zbatim të një akti ligjor të autoriteteve përkatëse të Republikës së Shqipërisë;

l) ndërmerr veprimtari për promovimin e interesave të veçantë të Republikës së Shqipërisë në marrëdhëniet me organizatat dhe organizmat ndërkombëtarë të mospërhapjes së armëve dhe të kontrollit të transferimeve ndërkombëtare të mallrave e kontrolluara;

ll) jep këshillim të specializuar dhe organizon programe informimi e fushata ndërgjegjësimi për

personat, fizikë dhe juridikë, përfshirë dhe autoritetet publike, mbi përparimet, objektivat, normat, procedurat dhe kufizimet e veprimtarisë me mallrat të kontrolluara;

m) merr pjesë në ekspozitat kombëtare dhe, sipas rastit, në ekspozitat ndërkombëtare të teknikës ushtarake dhe të teknologjisë së lartë;

n) ndërton dhe administron faqen zyrtare të internetit, të destinuar për informimin e operatorëve ekonomikë, të autoriteteve të tjera të interesuara dhe të shoqërisë civile për legjislacionin në fuqi dhe procedurat e licencimit.

16. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKSHE-së miratohet nga ministri, me propozimin e kryetarit.

17. AKSHE-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria ... (emri i ministrisë nga varet AKSHE-ja), Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

18. Vula e AKSHE-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e përdorimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. AFATET, MËNYRA DHE PROCEDURA PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT DHE MARRJES SË MENDIMIT NGA INSTITUCIONET E TJERA TË PËRFSHIRA NË TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE TË KONTROLLUARA

19. AKSHE-ja, për përmbushjen e detyrimeve ligjore, ka të drejtë të kërkojë të dhëna për transferimet ndërkombëtare të mallrave nga organet shtetërore dhe subjektet e tjera.

20. Me qëllim bashkërendimin e punës, hartimin e politikave, vlerësimin dhe dhënien e opinioneve për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, AKSHE-ja shkëmben dhe merr informacion nga:

a) ministria përgjegjëse për punët e jashtme;



b) ministria përgjegjëse për punët e brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

c) ministria përgjegjëse për financat/Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

ç) Shërbimi Informativ i Shtetit;

d) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

dh) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

AKSHE-ja mund të lidhë marrëveshje me institucionet e sipërpërmendura, si dhe me institucione të tjera, lidhur me përcaktimin e procedurave, të afateve dhe të modaliteteve për shkëmbimin e informacionit për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

21. Institucionet e përmendura në pikën 20 të këtij kreu, shqyrtojnë raste të veçanta të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, të cilat adresohen nga AKSHE-ja, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.

22. Institucionet e përmendura në pikën 20 të këtij kreu, shkëmbejnë informacion me AKSHE-në, sipas fushave të përgjegjësisë, si dhe bazuar në kriteret e vendosura në nenin 12, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

23. AKSHE-ja, për përmbushjen e detyrimeve ligjore, ka të drejtë të kërkojë informacione edhe nga institucionet e tjera shtetërore, vetëm në funksion të ushtrimit të veprimtarisë. Institucionet e përmendura në pikën 20 të këtij kreu, si dhe institucionet e tjera që mund të angazhohen në kontrollin e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, kthejnë përgjigje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune. Në rast se informacioni nuk mund t’i vihet në dispozicion, brenda këtij afati, në mënyrë të justifikuar, palët bien dakord për shtyrjen e tij.

24. Informacioni i dërguar nga institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera bëhet pjesë përbërëse e vlerësimit përfundimtar nga AKSHE-ja, mbi bazën e të cilit merret vendimi për miratim, refuzim të aplikimit apo shfuqizim të licencave, certifikatave dhe autorizimeve.

25. AKSHE-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është e detyruar të ruajë informacionin e klasifikuar, konfidencialitetin e të dhënave dhe sekretet tregtare të subjekteve të përfshira në licencim, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

26. AKSHE-ja mund të angazhojë organizma të tjerë shtetërorë gjatë zbatimit të masave të marra në procesin e kontrollit të eksportit, si përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, me pëlqimin e institucionit të varësisë, si dhe shërbimet e inteligjencës ose struktura të tjera të specializuara.

27. Afatet e komunikimit dhe të bashkëpunimit me institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, janë ato të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në legjislacionin për të drejtën e informimit, me përjashtim të rasteve kur respektimi i këtyre afateve është objektivisht i pamundur.

IV. PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E GARANCIVE DHE KRYERJEN E KONTROLLIT SHTETËROR, NË PËRPUTHJE ME DETYRIMET PËR PËRDO-RIMIN E FUNDIT TË MALLIT

28. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve jep garanci shtetërore, në lidhje me përdorimin e fundit të mallrave nëpërmjet lëshimit të certifikatës:

a) së përdoruesit të fundit;

b) ndërkombëtare të importit;

c) së mbërritjes së mallit në destinacion.

29. Certifikatat e përcaktuara në pikën 28 të këtij kreu, u lëshohen subjekteve të interesuara, sipas kërkesës së vendit eksportues dhe do të konsiderohen të vlefshme kur paraqiten brenda 6 muajve nga data e lëshimit. Kriteret për lëshimin e certifikatave përcaktohen me urdhër të kryetarit të AKSHE-së, në përputhje me pikën 3, të nenit 26, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

30. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve konfirmon edhe certifikata të përdoruesit të fundit të lëshuara nga autoritetet e huaja, sipas kërkesës së subjekteve të interesuara. Procedurat për konfirmimin e këtyre certifikatave



janë të njëjta me procedurat kur lëshohen nga vetë AKSHE-ja.

31. Për lëshimin e garancive shtetërore, AKSHE-ja dhe organet e tjera shtetërore të autorizuar kanë të drejtën të kontrollojnë dhe të inspektojnë ambientet, dokumentet e mbërritjes së mallrave në destinacion dhe përdorimin e mallrave në të gjitha fazat e transferimit ndërkombëtar edhe pas mbërritjes të përdoruesi i fundit vendës.

32. Inspektimi i përcaktuar në pikën 31 të këtij kreu, kryhet në përputhje me ligjin nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, dhe ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

33. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 43, datë 16.1.2008, “Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”, të ndryshuar, nr. 304, datë 25.3.2009, “Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e ekspertizave dhe të kontrollit nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)”, dhe nr. 305, datë 25.3.2009, “Për përcaktimin e procedurës së lëshimit të dokumenteve ligjore të garancisë në fushën e kontrollit shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë”, shfuqizohen.

34. Punonjësit e emëruar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk u nënshtrohen rishtazi procedurave të emërimit në detyrë.

35. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr. 33, datë 22.1.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MOSPËRHAPJEN E ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MOSPËRHAPJEN E ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË

PËRMBAJTJA

- SHKURTIMET
PËRKUFIZIME
I. TË PËRGJITHSHME
II. VIZIONI, MISIONI DHE PARIMET E PËRGJITHSHME
III. SYNIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT
1. PARANDALIMI
2. ZBULIMI
3. PËRGJIGJJA NDAJ RREZIQEVE
IV. PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË



1. KOORDINATORI KOMBËTAR
2. SEKRETARIATI TEKNIK
3. MINISTRITË E LINJËS
4. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR
- V. INFORMIMI I PUBLIKUT
- VI. ZBATIMI I STRATEGJISË
1. MONITORIMI DHE VLERËSIMI
2. LISTA E TREGUESVE
- VII. MEKANIZMAT LIGJORË
- VIII. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRINSTITUCIONALE PËR MOSPËRHAPJEN E ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË

SHKURTIMET

(Përmban të gjitha shkurtimet dhe akronimet e përdorura në material, sipas rendit alfabetik.)

AAC- Autoriteti i Aviacionit Civil

AAT- Autoriteti Atomik Shqiptar

ADM - Armët e Dëmtimit në Masë

AKBRN- Armët Kimike Bakteriologjike Radiologjike Nukleare

AKSHE - Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

FARSH- Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

M-ADM- Mospërhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë

MASR- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

MBZHR- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MD- Ministria e Drejtësisë

MFE- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

MTM- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

MM- Ministria e Mbrojtjes

MB- Ministria e Brendshme

MEPJ - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

MIE - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

QFBZ- Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar

SHISH- Shërbimi Informativ i Shtetit

SSK - Strategjia e Sigurisë Kombëtare

SU - Strategjia Ushtarake

UT- Universiteti i Tiranës

ZMR- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

PËRKUFIZIME

Këto përcaktime janë për përdorimin në këtë Strategji.

“Armët e Shkatërrimit në Masë (ADM)”, një armë me kapacitet shkatërrimi të lartë që shkakton dëme në shkallë të gjerë në njerëz, infrastrukturë dhe burime të tjera.¹ Në to përfshihen armët kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore.²

“Përhapja e Armëve të Shkatërrimit në Masë” nënkupton të gjitha përpjekjet e shteteve apo aktorëve joshitetorë, për të zhvilluar, për të blerë, për të prodhuar, për të zotëruar, për të transportuar, për të transferuar apo për të përdorur ADM-të ose pajisje dhe mjete të shpërndarjes, mallra me përdorim të dyfishtë apo mallra dhe teknologji që lidhen me të.

I. TË PËRGJITHSHME

ADM-ja në zotërim të shteteve armiqësore apo terroristëve përfaqësojnë një nga sfidat më të mëdha të sigurisë me të cilat përballet vendi ynë, rajoni dhe i gjithë komuniteti ndërkombëtar. Çdo veprim apo mosveprim që çon në përhapjen e ADM-ve, paraqet kërcënim për sigurinë kombëtare dhe interesat e saj të gjera.

Vendndodhja gjeografike e Republikës së Shqipërisë, në udhëkryqin e rrugëve që lidhin Evropën Perëndimore me atë Lindore dhe Azinë, si dhe kufijtë tokësorë, liqenorë, lumorë dhe detarë, e ekspozojnë vendin tonë kundrejt trafikimit të ADM-ve, materialeve të para për prodhimin e tyre, si dhe sistemeve të shpërndarjes.

Kjo Strategji do të bëjë të mundur që Shqipëria të krijojë premiset për M-ADM, nëpërmjet forcimit të kontrollit kufitar, përmirësimit të legjislacionit dhe zbatimit të ligjit, rritjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me partnerët tanë, duke ndëshkuar trafiket dhe krimin e organizuar. M-ADM dhe mbrojtja prej tyre është detyrim themelor i shtetit, për të siguruar kushte për një jetë të qetë dhe të sigurt të shtetasve të vet, krijimin e një mjedisi demokratik, tolerant dhe të begatë, në zbatim të plotë të ligjit.

Me qëllim përballimin e kësaj sfide, nevojitet hartimi i një Strategjie ndërinstitucionale dhe gjithëpërfshirëse, e cila do të adresojë këtë kërcënim në të gjitha dimensionet e tij si në kuadrin

¹ AAP 6 (2012), Fjalori i Termave dhe i Përkufizimeve (NATO Glossary of Terms and Definitions).

² Fjalori Bashkëkohor i Anglishtes i Longman-it (Longman Dictionary of Contemporary English).



kombëtar, ashtu dhe atë ndërkombëtar. Kjo Strategji vlerësohet si pjesë integrale e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK), e cila konsideron mjedisin e sotëm të sigurisë, rreziqet dhe kërcënimet, zhvillimet teknologjike, si dhe marrëdhëniet me vendet aleate dhe ato partnere.

Republika e Shqipërisë nuk zotëron ADM, si dhe nuk do të zhvillojë dhe nuk do të mbështesë asnjë veprimtari që çon në përhapjen e tyre, por do të kontribuojë me të gjitha kapacitetet, për përmirësimin dhe krijimin e mekanizmave kombëtarë të ndërveprueshëm me ato ndërkombëtarë, si dhe një sistem efikas dhe të pandarë për parandalimin, ndalimin dhe kontrollin e veprimeve që lidhen me përhapjen e ADM-ve.

Strategjia Kombëtare përcakton kuadrin e përgjithshëm të masave, mekanizmave dhe veprimeve që Republika e Shqipërisë do të ndërmarrë për M-ADM. Strategjia përcakton rolin e institucioneve dhe strukturave të ndryshme, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe publike dhe subjekteve të tjera juridike në Republikën e Shqipërisë, si dhe me shtetet e tjera dhe organizatat e sigurisë. Strategjia është pjesë integrale e kuadrit të strategjive kombëtare dhe plotëson mekanizmat e përgjigjes për menaxhimin e krizave dhe emergjencave.

Kjo Strategji do të mundësojë përmbushjen e detyrimeve që ka vendi ynë si anëtar i NATO-s dhe detyrimeve në kuadër të organizatave ndërkombëtare (OKB dhe OSBE). Republika e Shqipërisë, duke aspiruar anëtarësimin në BE, njëkohësisht pranon edhe detyrimet që rrjedhin prej tij, ku sipas Strategjisë së sigurisë evropiane, një nga pesë kërcënimet kryesore ndaj sigurisë është edhe përhapja e ADM-ve.

Strategjia dhe Plan i Veprimit synon harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian mbi Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe mbi fushat që lidhen me M-ADM, si dhe me Strategjinë e BE-së kundër përhapjes së ADM-ve, në përputhje me procesin e planifikimit të përafrimit me legjislacionin e BE-së, nëpërmjet Planit Kombëtar të Integritimit Evropian dhe me procesin e ardhshëm të negociatave të anëtarësimit në BE.

II. VIZIONI, MISIONI DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

Me rritjen e shfaqjeve të terrorizmit dhe agresivitetit të tij, si dhe me problematikat që mund të krijohen nga shtete të veçanta apo ato të dështuara ose aktorë joshitetërorë, M-ADM është vlerësuar si fenomen i cili do të ketë nevojë për vëmendje edhe më të madhe.

Vizioni: “Një Shqipëri e sigurt, pa armë të dëmtimit në masë apo çdo formë të përhapjes së tyre”

Misioni i kësaj Strategjie është përcaktimi i synimeve, objektivave dhe aktiviteteve për të siguruar M-ADM, si dhe harmonizimi i veprimeve ndërinstitucionale kombëtare dhe ndërkombëtare për të arritur objektivat finale të saj.

Strategjia bazohet në parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, Strategjisë Ushtarake, Strategjisë Kombëtare të Antiterrorizmit, Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufijve etj. Parimet që do të orientojnë gjithë aktivitetet dhe veprimtaritë në kuadër të Strategjisë së M-ADM janë:

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Strategjia për M-ADM bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionit në fuqi dhe konventave e dokumenteve ligjore ndërkombëtare.

Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe i garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën për siguri dhe mbrojtje të të gjithë qytetarëve, parim i cili përfshin edhe M-ADM, si dhe parandalimin e krimeve të lidhura me përhapjen e tyre.

Parimi i gjithëpërfshirjes dhe vazhdimësisë. Për adresimin e sfidës së mospërhapjes së ADM-së, kërkohet përfshirja e vazhdueshme dhe përdorim sinergjik dhe i integruar i të gjitha institucioneve dhe aktorëve shtetërorë dhe joshitetërorë.

Parimi i ndarjes së përgjegjësisë. Çdo nivel qeverisjeje ka përgjegjësinë e vet në zbatimin e planit të veprimit për M-ADM.

Përfaqja rajonale. Për të adresuar përhapjen e ADM-ve, përtej përfaqesës gjithëpërfshirëse, nevojitet edhe adresimi rajonal e më gjerë. Shqipëria respekton detyrimet e mbrojtjes kolektive³. Në këtë kontekst, kjo Strategji mbështet bashkëpunimin rajonal me vendet aleate dhe

³ Siguria e një shteti është e pandashme nga siguria e shteteve të tjera.



partnere në aspektet e shkëmbimit të informacionit, eksperiencës, si dhe koordinimin e luftës kundër krimit të organizuar.

Parimi i informimit, transparencës dhe llogaridhënies: Bazohet në të drejtën e qytetarëve dhe publikut, për informim mbi rreziqet dhe pasojat e përhapjes së ADM-ve dhe progresin në implementimin e Planit të Veprimit, deri në përmbushjen e çdo detyrimi.

Metodologjia: Përqaşja gjithëpërfshirëse vlerësohet si domosdoshmëri dhe guri i themelit për suksesin e M-ADM, ku të gjitha institucionet veprojnë së bashku në përgjigje të kësaj sfide. Si e tillë, Republika e Shqipërisë do të kontribuojë në M-ADM, duke rritur bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikën e normëzuara ndërkombëtare. Për të pasur sukses në M-ADM, kjo Strategji duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet në të gjitha nivelet (qendrore dhe lokale), duke siguruar dhe duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në lidhje me zbatimin e saj.

III. SYNIMI DHE FUSHA E ZBATIMIT

Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- përmirësimit të kuadrit ligjor për rregullimin e aktiviteteve dhe veprimtarive për ndalimin e përhapjes së ADM-ve;

- zhvillimit të sistemeve dhe mekanizmave administrativë për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe zbatimit të detyrimeve ndërmjet institucioneve që kanë përgjegjësi në zbatimin e Strategjisë së M-ADM;

- përmirësimi i procedurave për rritjen e kontrollit dhe ndalimin e furnizimit ilegal me materialet, që mund të shërbejnë për krijimin e ADM-ve dhe materialet me përdorim të dyfishtë;

- rritjes së efikasitetit të hetimit dhe ndëshkimit të kriminalitetit (krimit të organizuar), në mënyrë specifike krimit të lidhur me prodhimin dhe trafikimin e ADM-ve;

- rritjes së sigurisë, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal, koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit midis institucioneve, aleatëve dhe partnerëve, kundër krimit të organizuar dhe përhapjes së ADM-ve;

- fushat e zbatimit të kësaj Strategjie janë: *parandalimi, zbulimi dhe përgjigja ndaj rreziqeve (reagimi)* në rast incidenti.

Drejtimit kryesorë të kësaj Strategjie janë:

- a) rritja e sigurisë kombëtare, duke parandaluar që Republika e Shqipërisë të bëhet vend i kalimit, prodhimit, blerjes, zotërimit, transportimit, përdorimit dhe trafikimit të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërndarjes, të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë apo mallra dhe teknologjive ushtarake që lidhen me të;

- b) përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kombëtare, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe sigurimit të kushteve për të rritur M-ADM;

- c) kompletimi i sistemeve dhe i mekanizmave me kuadrin e duhur ligjor, burime njerëzore, financiare dhe materiale për reagim të shpejtë dhe efikas në raste incidentesh apo emergjencash që lidhen me përhapjen apo përdorimin e ADM-ve;

- ç) dhënia e kontributeve në përpjekjet e komunitetit, organizatave dhe institucione ndërkombëtare (ku ne aderojmë) për ndalimin e përhapjes së ADM-ve.

Kjo do të arrihet nëpërmjet përmbushjes së objektivave specifike, si më poshtë:

Objektivi 1: Përmirësimi i politikave dhe vendosja e sistemeve efikase për ndalimin e hyrjes ilegale të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivi 2: Plotësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor sipas nevojës për të garantuar suksesin në ndalimin e hyrjeve ilegale të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre.

Objektivi 3: Ngritja apo përmirësimi i sistemeve, kapaciteteve dhe procedurave standarde efektive që sigurojnë kontrollin e plotë të importeve, eksporteve dhe tranziteve për parandalimin e përhapjes së ADM-ve.

Objektivi 4: Zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve njerëzore, teknike dhe teknologjike, si dhe zhvillimi i procedurave standarde efikase për parandalimin e përhapjes së ADM-ve.

Objektivi 5: Vijimi i rritjes së profesionalizmit të Policisë Kufitare, Policisë së Shtetit dhe punonjësve të doganave, në adresimin e incidenteve që lidhen me trafikimin, përhapjen dhe përdorimin e ADM-ve.



Objektivi 6: Rritja e numrit të hetimeve efikase dhe të suksesshme në luftën kundër krimit të lidhur me përhapjen e ADM-ve, zotërimit ilegal dhe trafikimit të materialeve apo i informacionit, që i shërben prodhimit dhe përdorimit të ADM-ve.

Objektivi 7: Përmirësimi dhe rritja e bashkëpunimit, shkëmbimi i informacionit dhe ndihmës reciproke mbi trafikimin, prodhimin, zotërimin ose përdorimin e ADM-ve, midis: MM (AKSHE), MD, MFE (doganat) dhe MB (Policia e Shtetit, Policia Kufitare dhe e Emigracionit, Policia Rrugore), institucioneve hetimore dhe Prokurorisë, vendeve të rajonit dhe atyre aleate, si dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Objektivi 8: Përmbushja dhe zbatimi me rigorozitet i detyrimeve që rrjedhin nga traktatet, konventat dhe memorandumet ndërkombëtare (përfshi edhe embargot dhe kufizimet në kuadër të OKB-së dhe BE-së).

Objektivi 9: Zbatimi me rigorozitet i normave, rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të magazinimit dhe ruajtjes së materialeve me përdorim të dyfishtë apo atyre që mund të shërbejnë për prodhimin e ADM-ve.

Objektivi 10: Rritja e rolit aktiv në diplomaci, pjesëmarrja në koalicionet kundër përhapjes së ADM-ve dhe promovimi i veprimtarive të Armë-Kontrollit në mbështetje të M-ADM.

Objektivi 11: Përmirësimi i bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe subjektet private, me qëllim zgjerimin e njohurive dhe ndërgjegjësimin e tij.

1. PARANDALIMI

Parandalimi i përhapjes së ADM-ve përfshin të gjitha aktivitetet dhe masat të cilat zvogëlojnë mundësinë e krijimit të kushteve për përhapjen, zhvillimin, prodhimin dhe përdorimin e ADM-ve. Mund të jenë një sërë subjektesh, të tillë si: persona fizikë apo juridikë, individë, grupe dhe shtete të cilët mund të synojnë shfrytëzimin e territorit të Republikës së Shqipërisë për përhapjen e ADM-ve, si dhe për të anashkaluar mekanizmat dhe regjimet ndërkombëtare për kontrollin e armatimit ose mallrave me përdorim të dyfishtë dhe mjeteve të përdorimit të tyre.

Për të parandaluar përhapjen e ADM-ve, objektiv kryesor do të jetë rritja e ndërgjegjësimit publik dhe shkëmbimit të informacionit midis strukturave, grupeve të interesit dhe bashkësisë ndërkombëtare. Në këtë kontekst synohet që

sistemi kombëtar për ndalimin e përhapjes së ADM-ve, të përmirësohet nëpërmjet:

- ndërgjegjësimi të publikut për natyrën dhe seriozitetin e kërcënimeve që lidhen me ADM-të;

- koordinimi të aktiviteteve, si midis institucioneve shtetërore, ashtu edhe me partnerët ndërkombëtarë;

- bashkëpunimit dhe krijimit të marrëdhënieve të partneritetit midis institucioneve shtetërore dhe grupeve të interesit, përfshirë publikun, subjektet private, komunitetin akademik, sektorin e industrisë dhe institucionet financiare;

- përmirësimi të sistemit kombëtar të shkëmbimit të informacionit;

- forcimit të mbikëqyrjes së masave të sigurisë, që lidhen me vendet ku ruhen materialet e rrezikshme kimike apo mallrat me përdorim të dyfishtë;

- forcimit të masave për mbikëqyrjen e transferimit të teknologjisë jomateriale;

- mbështetjes së iniciativave rajonale dhe globale në këtë fushë;

- intensifikimit të përpjekjeve për ndërprerjen e aktiviteteve kriminale dhe terroriste, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe procedurat standarde për mospërhapjen e ADM-ve;

- edukimit dhe trajnimit të të gjithë aktorëve, për lidhjen e aktiviteteve të tyre me ADM-të, si dhe përfshirja e kërkimit shkencor në programet e mospërhapjes së ADM-ve;

- bashkëpunimit në kuadër të agjendës së sigurisë globale shëndetësore dhe zbatimit të Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit.

2. ZBULIMI

Zbulimi nënkupton identifikimin në kohë reale të të gjitha kërcënimeve dhe rreziqeve, që vijnë nga aktivitetet e përhapjes së ADM-ve. Rishikimi i arkitekturës së komunikimit në fushën e menaxhimit të kufijve, si dhe zhvillimi i mekanizmave dhe sistemeve kombëtare ndërvepruese me ato ndërkombëtare do të orientojnë aktivitetet si më poshtë:

- përforcimi i kapaciteteve për njoftimin e hershëm dhe reagimin e shpejtë për të gjitha situatat që lidhen me përhapjen e ADM-ve;

- shfrytëzimi i kapaciteteve kombëtare, për zbulimin në kohë të materialeve jashtë kontrollit ligjor, si dhe materialeve me përdorim të dyfishtë, të cilat mund të përdoren për prodhimin ose përdorimin e ADM-ve;



- rritja e kapaciteteve për kontrollin e kufijve dhe ndalimin e trafikimit të ADM-ve dhe materialeve që përdoren për ndërtimin e tyre;

- shfrytëzimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative, për zbulimin e rrjeteve financiare kriminale që tentojnë përhapjen e ADM-ve;

- mbikëqyrja e normave dhe e procedurave të transportit të mallrave dhe të teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe mallrave ushtarake;

- mbikëqyrja e transfertave financiare dhe e aktiviteteve të ndërmjetësimit të biznesit, të cilat mund të lidhen me përhapjen e ADM-ve;

- përdorimi i burimeve dhe i programeve të organizatave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zbulimin e ADM-ve;

- shfrytëzimi i të gjitha mënyrave të bashkëpunimit me aleatët dhe partnerët, si dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, për zbulimin e aktiviteteve të lidhura me përhapjen e ADM-ve;

- zbulimi dhe njoftimi në kohë i të gjitha ngjarjeve të shkaktuara nga armët KBRN në strukturat përkatëse kombëtare.

3. PËRGJIGJJA NDAJ RREZIQEVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë siguron drejtëm, planifikim, mbikëqyrje dhe koordinim të centralizuar të sistemit të menaxhimit të krizave, ku përfshihen edhe incidentet apo krizat e shkaktuara prej përhapjes së ADM-ve. Objektivi në këtë fushë mbetet ruajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe i aftësive për të reduktuar në maksimum pasojat e përdorimit të ADM-ve në Republikën e Shqipërisë. Për reagimin e duhur dhe të menjëhershëm në përballjen me incidentet që mund të përfshijnë trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, si dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e kufijve, nevojitet rritja e profesionalizmit të Policisë Kufitare, Policisë së Shtetit, si dhe punonjësve të doganave. Në përgjigje ndaj kërcënimeve, incidenteve apo krizave, të gjitha kapacitetet dhe burimet në dispozicion, do të shfrytëzohen për ndalimin e të gjitha aktiviteteve, personave dhe mallrave, të cilët janë vënë në shërbim të përhapjes së ADM-së apo janë të lidhura me:

- zhvillimin, prokurimin, prodhimin dhe përdorimin e ADM-ve;

- transportimin e mallrave, materialeve dhe njerëzve;

- transferimin e teknologjive dhe njohurive për përhapjen e ADM-ve;

- transferimin e parave apo të mjeteve të tjera financiare në funksion të përhapjes së ADM-ve;

- neglizhencën në përdorimin dhe ruajtjen e mjediseve, ku magazinohen materialet që mund të përdoren për zhvillimin e ADM-ve.

IV. PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

1. KOORDINATORI KOMBËTAR

Koordinatori Kombëtar është personi që ka mandatin të koordinojë, të drejtojë, të monitorojë dhe të raportojë për implementimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të Strategjisë për M-ADM.

Nisur nga roli që ka për mospërhapjen e armëve të dëmimit në masë, koordinatori kombëtar caktohet nga Ministria e Mbrojtjes. Koordinatori kombëtar ndjek realizimin e Planit të Veprimit dhe paraqet te Kryeministri raportin vjetor të zbatimit të kësaj Strategjie dhe planit të saj të veprimit.

Ministria e Mbrojtjes do të jetë përgjegjëse për adresimin e situatave emergjencave që lidhen me përhapjen apo trafikimin e Armëve të Dëmimit në Masë me mbështetjen e institucioneve bashkëpunuese sipas kësaj Strategjie.

2. SEKRETARIATI TEKNIK

Sekretariati teknik do të drejtohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe do të ketë në përbërje përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe AKSHE, SHPFA. Ai do të grumbullojë, do të analizojë dhe do të vlerësojë informacionin nga institucionet e tjera, si dhe do të hartojë raportet analitike për koordinatorin kombëtar dhe raportet kombëtare për institucionet dhe organizatat ndërkombëtare (OSBE, OKB, RACVIAC etj.). Sekretariati ka për detyrë koordinimin e aktiviteteve të parashikuara në planin kombëtar të veprimit, monitorimin e zbatimit të tij, si dhe sugjerimin e përditësimit në varësi të situatës.

3. MINISTRITË E LINJËS

Bashkëpunimi ndërinstitucional ka rëndësi të veçantë për M-ADM. Autoritetet përgjegjëse për zbatimin dhe aplikimin e regjimeve/ marrëveshjeve / konventave ndërkombëtare, në parandalimin e përhapjes së ADM -ve janë: MEPJ, MB dhe MM (AKMC, AKSHE).

Ministria e Brendshme (MB), nëpërmjet strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit, do të



kontribuojë në zbatimin e kësaj Strategjie, duke rritur parametrat e sigurisë së kufijve kombëtarë dhe luftuar trafikimin e paligjshëm të ADM-ve. Për të luftuar trafikimin Ministria e Brendshme do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet ligjzbatuese dhe agjencitë inteligjente, përfshirë institucionet e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare (QNOD).

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) është institucioni koordinues që ndjek zbatimin e konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. MEPJ-ja, në bashkëpunim me strukturat e tjera, koordinon punën dhe përcjell raportet e kërkuara mbi mospërhapjen e ADM-ve, në organizatat ndërkombëtare, të përgatitura nga institucionet kompetente.

Ministria e Mbrojtjes (MM) mbështet përmbushjen e objektivave të kësaj Strategjie nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe me ekspertizë, kur i kërkohet nëpërmjet AKSHE-së, e cila siguron që licencimi i individëve dhe subjekteve të biznesit, të bëhet sipas ligjeve që lidhen me eksportin dhe importin në Republikën e Shqipërisë të mallrave me përdorim të dyfishtë, mallrave ushtarake dhe mallrave të teknologjisë me përdorim të dyfishtë. AKSHE-ja, në bashkëpunim me doganat dhe MB-në, të cilat janë aktorët kryesorë për M-ADM-në, do të zbatojë plotësisht kornizën ligjore dhe aktivitetet për kontrollin e mallrave ushtarake dhe atyre me përdorim të dyfishtë. Për këtë qëllim do të hartohet një Memorandum Bashkëpunimi. MM-ja ka përgjegjësi menaxhimin e njohurive, informacionit edhe ekspertizës që ka FARSH-ja, si dhe zhvillimin e kapaciteteve operationale që do të adresojnë incidentet në rast përhapjeje apo përdorimi të ADM-ve.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është përgjegjëse për marrjen e informacionit mbi sigurinë dhe rreziqet e ADM-ve për shëndetin, me qëllim hartimin e masave parandaluese dhe trajtimin në rastet e emergjencave shëndetësore. Për përmbushjen e synimeve të kësaj Strategjie. MSHMS-ja zhvillon kapacitetet për monitorimin, kontrollin dhe adresimin e incidenteve që lidhen me përhapjen e ADM-ve, si dhe duke parandaluar aktivitetin kriminal, në strukturat që kanë lidhje me rrezatimin apo ku përdoren aparatura me materiale radioaktive.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) kontribuon në informimin dhe parandalimin e përhapjes së ADM-ve, nëpërmjet moduleve për “Mbrojtjen nga fatkeqësitë” dhe aktivitetet shkollorë, si dhe duke organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese dhe fushata ndërgjegjësimi me nxënësit, prindërit dhe pjesëtarët e komunitetit.

Ministria e Drejtësisë (MD) ka ndikim në M-ADM, duke forcuar sundimin e ligjit dhe ndëshkimin e aktivitetit kriminal apo ilegal që lidhet me blerjen, zotërimin, shitjen, shpërndarjen, importin, eksportin dhe prodhimin e ADM-ve dhe mjeteve të përdorimit të tyre. MD-ja ka përgjegjësinë për plotësimin e legjislacionit për të rritur efikasitetin në përmbushjen e synimeve të Strategjisë, duke përmirësuar kapacitetet e shërbimit korrektues dhe ndëshkues.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) është përgjegjëse për tregtinë dhe autoritetet kompetente për kontrollin në treg të mallrave, që mund të shërbejnë për prodhimin e ADM-ve dhe e ushtron rolin e saj në kontrollin e të gjitha transfertave monetare dhe kontrollin e veprimtarisë së ndërmarrjeve private, me qëllim që të parandalojë veprimtaritë e lidhura me përhapjen e ADM-ve. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, si agjenci për zbatimin e ligjit nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kanë një rol kyç në kontrollin e të gjitha mallrave që hyjnë dhe dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, veçanërisht monitorimi i zbatimit të rregullave në lidhje me importin, eksportin dhe transportin e materialeve radioaktive dhe bërthamore dhe monitorimin e licencave për import, eksport ose tranzit të lëshuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) në MSHMS.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) do të bashkëpunojë me Ministrinë e Mbrojtjes për monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve të mjedisit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) duke konsideruar rreziqet e krijimit të ADM-ve, kontribuon si autoriteti kompetent për licencimin e veprimtarive, që lidhen me kimikatet dhe mallrat që mund të përdoren për krijimin e ADM-ve.



Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), në zbatim të kësaj Strategjie, do të ofrojë bashkëpunim dhe informacion mbi aktivitete të lidhura me krimin e organizuar dhe me përhapjen e ADM-ve, si dhe mbi materialet që mund të përdoren për prodhimin apo përdorimin e tyre, pasi ato përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare.

1. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Përhapja, prodhimi, shpërndarja dhe përdorimi i ADM-ve janë çështje për të cilat kërkohet bashkëpunim i institucioneve, shkëmbimi i informacionit dhe ndihmës reciproke të vendeve fqinje, aleate dhe partnere, si dhe organizatave rajonale dhe globale. Ndalimi i përhapjes është i lidhur me zbatimin e ligjit, gjë që kërkon realizimin e hetimeve ndërkombëtare dhe luftë kundër krimit të organizuar. Me këtë Strategji synohet krijimi i kushteve për të adresuar mospërhapjen e ADM-ve, në bashkëpunim institucionet dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë të përfshirë në M-ADM, të tillë si: OKB-ja, BE-ja, NATO-ja, OSBE-ja, si dhe partnerët strategjikë, si: SHBA-ja, vendet e Aleancës, vendet fqinje dhe ato partnere.

V. INFORMIMI I PUBLIKUT

Informimi i publikut dhe ngritja e vetëdijes mbi rreziqet që lidhen me përhapjen e ADM-ve, është pjesë integrale e aktiviteteve për të arritur efikasitetin në mospërhapjen e tyre. Informimi i publikut, si parimi bazë për transparencën dhe llogaridhënien, do të krijojë kushtet për krijimin dhe rritjen e besimit të shteti, si dhe do të ndikojë në uljen e motivimit që një person fizik ose juridik të angazhohet në veprimtari kriminale, të lidhura me përhapjen e ADM-ve.

Transmetimi për publikun i informacionit të saktë, objektiv dhe pa deformime, mbi çështjet që lidhen me përhapjen e ADM-ve, është kompetencë dhe përgjegjësi e Kryeministrit dhe MB-së. Ai monitorohet dhe realizohet nga institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe format me anë të edukimit (module mësimore, seminare, konferenca), trajnimit, stërvitjeve, ekspozitave, si dhe nëpërmjet medieve.

Duke konsideruar rritjen e përdoruesve të internetit dhe rrjeteve sociale, që janë mjet efikas për përhapjen e informacionit, duhen krijuar mekanizma për të menaxhuar dhënien e saktë dhe të padeformuar të informacionit. Gjithashtu, këto

burime janë subjekt i sulmeve kibernetike, veprimeve të qëllimshme apo të paqëllimshme për përhapjen e informacionit jorealit e të saktë, të cilat mund të deformojnë perceptimin e publikut, dezinformojnë ose përhapin panik në popullatë.

Në rastet e krizave informacioni për publikun sigurohet nëpërmjet institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

VI. ZBATIMI I STRATEGJISË

1. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Strategjia e M-ADM-së është një tjetër dokument i sigurisë kombëtare, e cila orienton të menduarit dhe të vepruarit në mjedisin e sotëm, ku sikurse siguria edhe rreziqet nuk mund të trajtohen të shkëputura, por të lidhura me njëra-tjetrën.

Ky dokument u hartua në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga SSK-ja dhe nga dokumente të tjera strategjike në Republikën e Shqipërisë, bazohet në Konceptin Strategjik të Aleancës (Lisbonë 20-10), si dhe reflekton detyrimet që rrjedhin nga rezoluta 1540 e KS-së së OKB-së.

Strategjia për M-ADM-në, do të mbështetet me planin e veprimit për plotësimin e kuadrit ligjor, zhvillimin e kapaciteteve dhe hartimin e procedurave efikase për zbatimin e saj.

Procesi i zbatimit të Strategjisë do të përfshijë përmbushjen e synimeve dhe objektivave, sipas fushave përkatëse që mbulojnë institucionet dhe sipas planit të veprimit bashkëlidhur kësaj Strategjie. Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të bërë në përmbushjen e tyre do të bazohet në shkallën e realizimit të treguesve të kësaj Strategjie. Procesi i monitorimit do të bëhet nga institucionet përgjegjëse nën drejtimin e MM-së.

Strategjia për mospërhapjen e ADM-ve do të rishikohet si rregull, pas pesë vjetësh, në varësi të zhvillimeve të situatës dhe mjedisit të sigurisë.

Progresi i zbatimit të Strategjisë së M-ADM-së do të monitorohet dhe vlerësohet në bazë të treguesve të cilët do të trajtohen më poshtë.

2. LISTA E TREGUESVE:

1. Numri i ligjeve dhe i akteve nënligjore që janë hartuar apo përditësuar;

2. Numri i ligjeve dhe i akteve nënligjore që janë zbatuar me sukses pas miratimit të Strategjisë;

3. Numri i strukturave të krijuara apo të rishikuara;

4. Numri i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të nënshkruara me shtetet e tjera;



5. Pajisjet e reja për zbulimin dhe gjurmimin e ADM-ve dhe materialeve që mund të përdoren për prodhimin e tyre;

6. Raportet e zbatimit të Strategjisë;

7. Modulet mësimore/kurrikulat dhe numri i librave shkollorë që adresojnë përhapjen e ADM-ve;

8. Numri i personave të dënuar për krime që përfshijnë përhapjen e ADM-ve;

9. Numri i rasteve të trajtuara nga policia, prokuroria dhe gjykatat.

VII. MEKANIZMAT LIGJORË

Republikës së Shqipërisë kontribuon në forcimin e stabilitetit, paqes dhe sigurisë në rajon dhe në botë. Ajo do të vijojë angazhimin në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga traktatet, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara prej saj, në fushën e mospërhapjes së ADM-ve. Shqipëria zbaton dhe do të vijojë të zbatojë me korrektësi të gjitha procedurat, normat dhe rregullat përkatëse të NATO-s, BE-së, si dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe OKB-së, duke marrë pjesë aktive në regjimet dhe iniciativat e M-ADM-së. Republika e Shqipërisë i ka përmbushur detyrimet e saj, veçanërisht në implementimin e Rezolutës 1540 (2004) së KS-së së OKB-së, për harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar në parandalimin e përhapjes së ADM-ve. Shqipëria është anëtare e të gjitha organizatave kryesore ndërkombëtare dhe rajonale që kanë si qëllim kryesor të tyre M-ADM-në dhe sistemeve të shpërndarjes të tyre, si: OKB-ja, NATO-ja, OSBE-ja, IAEA-ja, OPCW-ja, RCC-ja, RACVIAC-ja.

Republika e Shqipërisë është pjesë ose mbështet marrëveshjet, regjimet dhe konventat më të rëndësishme ndërkombëtare, që trajtojnë fenomenin e M-ADM, të tilla si:

- Traktati i Mospërhapjes së Armëve Nukleare, 1990;

- Konventa e Armëve Kimike, 1993;

- Konventa e Armëve Toksike dhe Biologjike, 1993;

- Traktati i Ndalimit të Provave Bërthamore, 2003;

- Rezoluta 1540 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, 2004;

- Konventa për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor, 1987;

- Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes Kundër Përhapjes së Raketave Balistike, i njohur dhe si *The Hague Code of Conduct – HCOC*;

- Marrëveshja Wassenaar, 2005;

- Grupi i Furnizuesve Bërthamorë, 2005;

- Nisma e Sigurisë së Përhapjes, 2004;

- Nisma botërore për të luftuar terrorizmin bërthamor, 2007;

- Regjimi i Kontrollit të Teknologjive të Raketave;

- Komiteti Zangger ose *Nuclear Exporters Committee*, 2006;

- Forumi Grupi Australian, 2007;

- Protokolli i Gjenevës, Gjeneva 1925;

- Protokolli shtesë me IAEA, mbi aplikimin e garancive në të gjitha aktivitetet nukleare të Republikës së Shqipërisë, 2004;

- Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit;

- Kuadri i brendshëm ligjor ekzistues që lidhen me Strategjinë M-ADM;

- Ligji nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”;

- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për shërbimin informativ kombëtar”, i ndryshuar;

- Ligj nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”;

- Ligji nr. 9092, datë 3.7.2003, “Për zbatimin e “Konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre”;

- Ligj nr. 118/2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”;

- Ligji nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”;

- Ligji nr. 8875, datë 4.4.2002, “Për rojën bregdetare shqiptare”, i ndryshuar;

- Ligj nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;

- Ligj nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar;



- Ligji nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”;

- Ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”;
- Memorandumi i Mirëkuptimit nr. 7690, datë 5.12.2011, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) dhe Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), “Për bashkëpunimin për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave teknologjike me përdorim të dyfishtë”.


PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MOSPËRHAPJEN E ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË
I. QËLLIMI STRATEGJIK

Përmbushja e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë dhe të institucioneve shtetërore të saj, në zbatim të përgjegjësiqve që burojnë nga Rezoluta 1540 e KS-së së OKB-së, për ndalimin e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM), në nivel rajonal dhe global; përmbushja e detyrimeve që ka vendi ynë si anëtar i NATO-s dhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare (OKB-së dhe OSBE-së), si dhe mbështetja e objektivit madhor të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ku, sipas strategjisë së sigurisë evropiane, një nga pesë kërcënimet kryesore ndaj sigurisë është edhe përhapja e ADM-ve.

II. Qëllimi i politikës

Të kontribuojë në miradministrimin, menaxhimin efektiv të fondeve dhe përmbushjen e detyrimeve financiare për personelin e MM-së dhe SHPFA-së, përfaqësitë ushtarake, shtabet e NATO-s, sipas detyrimeve ligjore të përfshirjes në iniciativat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare.

II. PROGRAMI BUXHETOR 1 QË KONTRIBUON PËR QËLLIMIN E POLITIKËS

Emërtimi i programit buxhetor: Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi; programi forca e luftimit; arsimimi ushtarak

Nr.		Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit (për vitet e PAB-së 1–3 të specifikuar në 3-mujore; për vitet përtej PBA-së të specifikuar mundësisht në 6-mujore)		Kostoja indikative (në mijë lekë) (këto kosto janë totalet, përlllogaritur sipas formateve të kostimit. Format i kostimit IPSIS)	Burimi i mbulimit	Hendeku financiar
					Afati i fillimit	Afati i mbarimit			
1.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 1 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Përmirësimi i politikave dhe vendosja e sistemeve efikase për ndalimin e hyrjes ilegale të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për Objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	3088	3088	0



1.1	Analiza dhe vlerësimi i situatës	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ produkt gjithëburimësh inteligjence, i saktë, në kohë dhe me cilësi/ 01110	MM	MEPJ, MB, MFE, MSHMS MBZHR, MTM, MIE, MASR, SHISH	2020	2021	576	576	0	
1.2	Përcaktimi i rreziqeve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ produkt gjithëburimësh inteligjence, i saktë, në kohë dhe me cilësi 01110	MEPJ	MM, MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2021	576	576	0	
1.3	Hartimi i politikave/i planeve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MEPJ	MM, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH, MB	2020	2020	576	576	0	
1.4	Implementimi i planeve/të Strategjisë	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MM	MEPJ, MB, MFE, MSHMS MBZHR, MTM, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	400	400	0	
1.5	Ngritja e sistemit të mësimave të nxjerra	Arsimi ushtarak/ strukturë funksionale për arsimin e FA-së A/09430	MM	MEPJ, MB, MFE, MSHMS MBZHR, MTM, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	600	600	0	
1.6	Asistencë në hartimin e politikave dhe të planeve (trajnime/seminare/ stërvitje)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE, MB, MEPJ	MM, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2021	40	40	0	
1.7	Asistencë në zbatimin e politikave dhe të planeve (trajnime/seminare/stërvitje)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE, MB, MEPJ	MM, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	40	40	0	
1.8	Asistencë në ngritjen e sistemeve (konferenca/vizita)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara	MFE, MB, MEPJ	MM, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2021	40	40	0	



		E/01110								
1.9	Analiza/raporti vjetor i realizimit të Strategjisë	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MM	MEPJ, MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	40	40	0	
1.10	Vlerësimi i efektivitetit dhe metodologjisë së planifikimit	Arsimi ushtarak/ strukturë funksionale për arsimin e FA-së A/09430	MM	MEPJ, MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	40	40	0	
1.11	Rishikimi i politikave dhe i sistemeve	Arsimi ushtarak/ strukturë funksionale për arsimin e FA-së A/09430	MEPJ, MM	MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2022	2022	40	40	0	
1.12	Ndjekja e zbatimit të konventave dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare ekzistuese dhe adaptimi i rregullave të reja në lidhje me politikat e mospërhapjes së ADM-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MM	MEPJ, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	40	40	0	
1.13	Pjesëmarrja në përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin e përhapjes së ADM-së	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MEPJ	MB, MM, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	40	40	0	
1.14	Shkëmbimi i informacionit në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MEPJ, MB	MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	40	40	0	
2.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 2 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Plotësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor, sipas nevojës për të garantuar suksesin në ndalimin e hyrjeve ilegale të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për Objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	795	795	0	
2.1	Vlerësimi i kuadrit ligjor ekzistues	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore	MFE, MM,	MEPJ, MB, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE,	2021	2022	45	45	0	



		C/01110		MASR, SHISH						
2.2	Rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE, MM,	MEPJ, MB, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
2.3	Plotësimi i mangësive në kuadrin ligjor	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE, MM	MEPJ, MB, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
2.4	Hartimi, miratimi dhe zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE, MM	MEPJ, MB, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
2.5	Rishikimi i urdhrave, udhëzimeve dhe rregulloreve ekzistuese	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE	MM, MB, MEPJ, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	60	60	0	
2.6	Vlerësimi i kuadrit ligjor ekzistues	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE	MM, MB, MEPJ, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
2.7	Miratim aktesh për plotësimin e mangësive në kuadrin ligjor, në përputhje me planifikimin në kuadër të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian dhe të procesit të negociatave të anëtarësimit në BE	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE	MM, MB, MEPJ, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
2.8	Përditësimi i listave të përbashkëta për mallrat me përdorim të dyfishtë	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MM, MFE	MB, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	150	150	0	
2.9	Harmonizimi me direktivën e BE-së, standardeve dhe rregullave ndërkombëtare të rregulloreve mbi sigurinë e materialeve gjenetike, agjentëve biologjikë etj.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MSHMS, MEPJ	MB, MM, MBZHR, MTM, MFE, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	120	120	0	
2.10	Marrja e masave për miratim aktesh rregullatore për implementimin e Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore	MB, MIE	MM, MFE, MBZHR, MEPJ, MTM, MSHMS,	2021	2022	60	60	0	



	sigurisë së lundrimit detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe protokollin 2005, të protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse në shelfin kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, si dhe të protokollit ndryshues të vitit 2005	C/01110		MASR, SHISH						
2.11	Aderimi dhe ratifikimi i Konventës së Pekinit (2010) për shtypjen e veprimtarive të paligjshme mbi sigurinë e aviacionit civil ndërkombëtar	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MIE, MB	MM, MFE, MBZHR, MEPJ, MTM, MSHMS, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
3.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 3 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Ngritja apo përmirësimi i sistemeve, kapaciteteve dhe procedurave standarde efektive që sigurojnë kontrollin e plotë të importeve, eksporteve dhe tranziteve për parandalimin e përhapjes së ADM-ve	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	3571	3571	0	
3.1	Përforcimi i legjislacionit mbi zbatimin e standardeve dhe Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetësisë mbi licencimin dhe sigurinë biologjike	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MSHMS	MB, MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MFE, MIE, MASR, SHISH	2021	2022	60	60	0	
3.2	Përditësimi i vazhdueshëm i listës së kontrollit dhe harmonizimi me atë të BE-së	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MSHMS, MM	MB, MEPJ, MBZHR, MTM, MFE, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	30	30	0	
3.3	Forcimi i sistemit të kontrollit	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MFE, MB	MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MIE, MASR, SHISH	2020	2022	30	30	0	
3.4	Formimi, zhvillimi i mëtejshëm i regjistrit kombëtar të materialeve dhe i teknologjisë të cilat mund të shërbejnë në këtë fushë	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/akte ligjore dhe nënligjore C/01110	MM	MEPJ, MFE, MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	60	60	0	



3.5	Forcimi i kontrollit të lëvizjes së njerëzve dhe të të mirave materiale në kufi	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MIE, MB	MM, MEPJ, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2022	60	60	0	
3.6	Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit në rrugë elektronike dhe përdorimi me efikasitet për mbajtjen nën kontroll të licencave të lëshuara/refuzuara etj.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/komunikimi i sigurt i informacionit F/01110	MM	MB, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MFE, SHISH	2020	2022	60	60	0	
3.7	Sigurimi i pajisjeve dhe teknikës së nevojshme, përmirësimi i infrastrukturës	Forcat e luftimit/ pajisje individuale dhe kolektive MADM AV/02120	MM, MB, MSHMS, MASR, MFE	MEPJ, MBZHR, MTM, MEI, SHISH	2020	2022	115	115	0	
3.8	Trajnime mbi përdorimin pajisjeve dhe teknikës	Forcat e luftimit/ pajisje individuale dhe kolektive MADM AV/02120	MM, MB, MSHMS, MASR, MFE	MEPJ, MBZHR, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	3,056	3,056	0	
3.9	Forcimi i masave të mbikëqyrjes dhe të sigurisë, që lidhen me ruajtjen e materialeve të rrezikshme kimike apo mallrat me përdorim të dyfishtë	Forcat e luftimit/ pajisje individuale dhe kolektive MADM AV/02120	MM, MSHMS, MIE, MFE	MB, MEPJ, MBZHR, MTM, MASR, SHISH	2020	2022	100	100	0	
4.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 4 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve njerëzore, teknike dhe teknologjike, si dhe zhvillimi i procedurave standarde efikase për parandalimin e përhapjes së ADM-ve	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	66, 422€ (8,103 lekë)	2,126	49,000€	
4.1	Bashkëpunimi me ekspertë të fushës (të huaj ose jo) dhe organizimi i trajnimeve me institucionet përgjegjëse	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/forcat e luftimit/arsimimi ushtarak. 01110/02120/09430	MEPJ, MB, MFE, MM	MBZHR, MTM, MSHMS, MASMS, MIE, SHISH	2021	2022	703 (5,762€)	703 (5,762€)	0	
4.2	Trajnime të personelit të Policisë së Shtetit dhe doganave mbi praktikatat më të mira të kontrollit të import/eksporteve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MEPJ, MB, MFE	MM, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2021	2022	3,000 € (366 lekë)	0	3,000 €	
4.3	Zhvillimi i seminareve, trajnimeve dhe takimeve me botën akademike për rreziqet që	Planifikimi, Menaxhimi dhe administrimi/forcat e	MAS, MM, MB	Universitet, institutet	2020	2022	10,000 €		10,000 €	



	sjell shkëmbimi dhe publikimi i informacioneve që mund të përdoren për prodhimin e ADM-ve	luftimit/arsimimi ushtarak 01110/02120/09430		kërkimore, MFE, MEPJ, MBZHR, MSHMS, MTM, MIE, SHISH			(1,220 lekë)	0		
4.4	Trajnimi i ekipeve për të reaguar në rast përdorimi të ADM-ve apo të emergjencave të shkaktuara si rezultat i incidenteve kimike	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ forcat e luftimit/arsimimi ushtarak 01110/02120/09430	MB, MM	MFE, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2022	10,000 € (1,220 lekë)	0	10,000 €	
4.5	Pjesëmarrja në konferenca dhe takime ndërkombëtare	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ forcat e luftimit/arsimimi ushtarak 01110/02120/09430	MM	MEPJ, MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2022	21,660 € (2,642 lekë)	1,423 (11,660€)	10,000 €	
4.6	Organizimi dhe pjesëmarrja në seminare dhe tavolina të rrumbullakëta	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ forcat e luftimit/arsimimi ushtarak 01110/02120/09430	MM, MEPJ	MFE, MB, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2022	10,000 € (1,220 lekë)	0	10,000 €	
4.7	Rritja e bashkëpunimit për asistencë dhe mbështetje	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ forcat e luftimit/arsimimi ushtarak 01110/02120/09430	MEPJ, MB, MM	MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2022	3,000 € (366 lekë)	0	3,000 €	
4.8	Rritja e kapaciteteve kombëtare	Forcat e luftimit/ pajisje individuale dhe kolektive MADM AV/02120	MB, MFE, MM	MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2022	3,000 € (366 lekë)	0	3,000 €	
5.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 5 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Vijimi i rritjes së profesionalizmit të Policisë Kufitare, Policisë së Shtetit dhe punonjësve të doganave, në adresimin e incidenteve që lidhen me trafikimin, përhapjen dhe përdorimin e ADM-ve	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	9,310€ (1,135 lekë)	37	9000€	
5.1	Rritja e bashkëpunimit dhe organizimi i trajnimeve me institucionet përgjegjëse	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE	MB, MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	3,100 € (378 lekë)	12	3,000 €	



5.2	Trajnimi i punonjësve të Policisë Kufitare dhe specialistëve të doganave mbi praktikat më të mira të kontrollit të import-eksporteve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB,	MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	3,090 € (377 lekë)	10	3,000 €	
5.3	Trajnimi i ekipeve për të reaguar në rast përdorimi të ADM-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB,	MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	3,120 € (380 lekë)	15	3,000 €	
6.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 6 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Rritja e numrit të hetimeve efikase dhe të suksesshme në luftën kundër krimit të lidhur me përhapjen e ADM-ve, zotërimin ilegal dhe të trafikimit të materialeve apo të informacionit, që i shërben prodhimit dhe përdorimit të ADM-ve	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për Objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	75	75	0	
6.1	Evidentim i procedurave që mund të aplikohen të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për transportimin e AMD-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB, MM	MEPJ, MBZHR, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	15	15	0	
6.2	Shfrytëzimi i kapaciteteve kombëtare, për zbulimin në kohë të materialeve të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për prodhimin apo përdorimin e AMD-ve.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB, MM	MPJ, MBZHR, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	15	15	0	
6.3	Shfrytëzimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative, për zbulimin e rrjeteve financiare kriminale që tentojnë përhapjen e AMD-ve.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB	MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	15	15	0	
6.4	Mbikëqyrja e transfertave financiare dhe aktiviteteve të ndërmjetësimit të biznesit, të cilat mund të financojnë përhapjen e AMD-ve.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB	MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	15	15	0	
6.5	Shkëmbimi i informacionit, përdorimi i burimeve dhe programeve të organizatave ndërkombëtare për zbulimin e trafikimit të AMD-ve.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MFE, MB,	MM, MEPJ, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, SHISH	2020	2021	15	15	0	



7.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 7 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Përmirësimi dhe rritja e bashkëpunimit, shkëmbimi i informacionit dhe ndihmës reciproke mbi trafikimin, prodhimin, zotërimin ose përdorimin e ADM-ve, midis: MM-së (AKSHE-së), MD-së, MFE-së (doganave) dhe MB-së (Policisë së Shtetit, Policisë Kufitare dhe të Emigracionit, Policisë Rrugore), institucioneve hetimore dhe Prokurorisë, vendeve të rajonit dhe atyre aleate, si dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	115	115	0	
7.1	Pjesëmarrje në takime dhe iniciativa të ndryshme	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi/Forcat e Luftimit/Arsimimi ushtarak. 01110/02120/09430	MEPJ, MM, MB, MFE	MSHMS, MASR, MIE, MTM, SHISH	2020	2022	15	15	0	
7.2	Shkëmbim informacioni, rritja e bashkëpunimit dhe krijimi i një rrjeti të përbashkët kombëtar	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110	MEPJ, MASR, MSHMS	MSHMS, MIE, MTM SHISH	2020	2022	15	15	0	
7.3	Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit nëpërmjet rrjetit elektronik	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110	MEPJ, MB, MM, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH		2020	2022	15	15	0	
7.4	Pjesëmarrje në takimet dhe iniciativat e ndryshme	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110	MB, MM, MEPJ	MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	15	15	0	
7.5	Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe shumëpalësh	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi/ Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara E/01110	MEPJ	MM, MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	10	10	0	
7.6	Shkëmbimi i informacionit, rritja e partneritetit dhe krijimi i një rrjeti rajonal komunikimi.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110	MEPJ	MM, MB, MSHMS, MASR, MD, MTM,	2020	2022	12	12	0	



				MIE, SHISH MM, MB, MSHMS, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	15	15	0	
7.7	Rritja e bashkëpunimit me Agjencinë Ndërkombëtare për Energjinë Bërthamore (IAEA)	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110	MEPJ, MASR							
7.8	Ndjekja e praktikave të aderimit dhe zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare shumëpalëshe për mospërhapjen e ADM-ve	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110	MEPJ, MM	MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	18	18	0	
8.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 8 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Përbushja dhe zbatimi me rigorozitet i detyrimeve që rrjedhin nga traktatet, konventat dhe memorandumet ndërkombëtare (përfshi edhe embargot dhe kufizimet në kuadër të OKB-së dhe BE-së)	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	324	324	0	
8.1	Traktati i Mospërhapjes së Armëve Nukleare (<i>Treaty on Non-Proliferation of Nuclear Weapons - NPT</i>), 1990	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM, MFE	MB, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MD, SHISH	2020	2022	18	18	0	
8.2	Konventa e Armëve Kimike (<i>Chemical Weapons Convention – on the Prohibition of the Development, Production, Stockpiling and use of Chemical Weapons, and their Destruction - CWC</i>), 1993	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MD, SHISH	2020	2022	18	18	0	
8.3	Konventa e Armëve Toksike dhe Biologjike (<i>Biological and Toxin Weapons Convention - BTWC</i>), 1993	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MD, SHISH	2020	2022	18	18	0	
8.4	Traktati i Ndalimit të Provave Bërthamore (<i>Treaty on Comprehensive Nuclear Test Ban - CTBT</i>), 2003	planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MD, SHISH	2020	2022	18	18	0	
8.5	Rezoluta 1540 e Këshillit të Sigurimit të	planifikimi, menaxhimi dhe	MEPJ, MM	MB, MFE,	2020	2022	18	18	0	



	OKB-së (<i>UN Security Council decides all states shall act to prevent proliferation of mass destruction weapons - Resolution 1540</i>), viti 2004	administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110		MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MD, SHISH						
8.6	Konventa për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor (<i>Convention on the Physical Protection of Nuclear Material- CPPNM</i>), 1987	planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MB, MFE, MBZHR, MTM, MSHMS, MASR, MIE, MD, SHISH	2020	2022	18	18	0	
8.7	Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes Kundër Përhapjes së Raketave Balistike (<i>International Code of Conduct against Ballistic Missile Proliferation - ICOC</i>)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.8	Traktati Gjithëpërfshirës i Ndalimit të Testeve Nukleare (<i>Comprehensive Nuclear Test Ban Treaty – CBTB</i>) (traktati nuk ka hyrë ende në fuqi)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.9	Marrëveshja Wassenaar (<i>The Wassenaar Arrangement on Export Controls for Conventional Arms and Dual-Use Goods and Technologies – WA</i>) (pjesëmarrëse në 2005)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.10	Grupi i Furnizuesve Bërthamorë (<i>Nuclear Suppliers Group – NSG</i>), 2005	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.11	Nisma e Sigurisë së Përhapjes (<i>Proliferation Security Initiative - PSI</i>), 2004	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.12	Nisma Botërore për të luftuar terrorizmin bërthamor (<i>Global Initiative to Combat Nuclear Terrorism - GICNT</i>) mbështetet nga Republikës së Shqipërisë prej vitit 2007	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.13	Vendi ynë mbështet Regjimin e Kontrollit të Teknologjive të Raketave (<i>The Missile Technology Control Regime - MTCR</i>)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	



8.14	Komiteti Zangger (<i>Zangger Committee ose Nuclear Exporters Committee - ZC</i> (RSH-ja u anëtarësua në vitin 2006))	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.15	Forumi Grupi Australian (<i>The Australia Group - AG</i>) (RSH-ja u anëtarësua në vitin 2007)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.16	Protokolli i Gjenevës që ndalon përdorimin e armëve kimike (<i>The Protocol for Prohibiting the use in war of toxic, poison gas and germ weapons, Geneva 1925</i>)	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.17	Protokolli shtesë me IAEA-në, “Mbi aplikimin e garancive në të gjitha aktivitetet nukleare të Republikës së Shqipërisë”, dhjetor 2004	Planifikimi, Menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MM	MD, MTM, MB, MFE	2020	2022	18	18	0	
8.18	Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MSHMS		2020	2022	18	18	0	
9.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 9 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Zbatimi me rigorozitet e normave, rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të magazinimit dhe i ruajtjes së materialeve me përdorim të dyfishtë apo atyre që mund të shërbejnë për prodhimin e ADM-ve	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	10,330\$ (1,126 lekë)	36 (330\$)	10,000\$	
9.1	Zhvillimi i programeve kombëtare për sensibilizimin e institucioneve për zbatimin e normave, rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të magazinimit dhe ruajtjes së materialeve me përdorim të dyfishtë apo atyre që mund të shërbejnë për prodhimin e ADM-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ forcat e luftimit/ arsimimi ushtarak 01110/02120/09430	MEPJ	MM, MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2021	2022	18 (165\$)	18 (165\$)	0	
9.2	Forcimi i bashkëpunimit me vendet fqinje dhe partnerët rajonalë, në kuadër të	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ forcat e	MM	MEPJ, MB, MSHMS, MASR,	2020	2022	10,165\$ (1,108 lekë)	18 (165\$)	10,000\$	



	detyrimeve që rrjedhin për zbatimin e rezolutës 1540.	luftimit/ arsimimi ushtarak 01110/02120/09430		MD, MTM, MIE, SHISH						
10.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 10 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Rritja e rolit aktiv në diplomaci, pjesëmarrja në koalicionet kundër përhapjes së ADM-ve dhe promovimi i veprimtarive të Armë-Kontrollit në mbështetje të M- ADM	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës (udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	90	90	0	
10.1	Aderimi dhe zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare për mospërhapijen e ADM-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara E/01110	MEPJ, MM, MFE	MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	18	18	0	
10.2	Pjesëmarrje aktive në aktivitete të armë-kontrollit, në lidhje me çështje të ADM-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MM, MEPJ	MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	18	18	0	
10.3	Ratifikimi i Konventës së Pekinit (2010), “Për shtypjen e veprimtarive të paligjshme mbi sigurinë e aviacionit civil ndërkombëtar”	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara E/01110	MEPJ, MIE	MM, MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	18	18	0	
10.4	Raportime të rregullta për implementimin e Rezolutës 1540	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MB, MM	MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	18	18	0	
10.5	Shkëmbim të vazhdueshëm informacionit me IAEA-në, OPCW-në, WCO-në etj.	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ komunikim i sigurt i informacionit F/01110	MEPJ, MB, MM	MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	18	18	0	
11.	IV. OBJEKTIVI SPECIFIK 11 (Të shkruhet emërtimi i objektivit specifik.) Përmirësimi i bashkëpunimit dhe i	(Plotësimi i kësaj kutie vlen vetëm për rezultatet, jo për objektivin.)	Shkruaj institucionin përgjegjës	Institucion kontribues (nëse ka)	2020	2022	4764	4764	0	



	marrëdhënieve me publikun dhe subjektet private, me qëllim zgjerimin e njohurive dhe ndërgjegjësimin e tij		(udhëheqës)							
11.1	Vlerësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe i marrëdhënieve të institucioneve qeveritare me publikun dhe subjektet private	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ arsimimi ushtarak 01110/09430	MM, MEPJ	MB, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	600	600	0	
11.2	Vlerësimi i moduleve edukative dhe identifikimi i nevojave për module të përfshira në programet dhe kurrikulat mësimore	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ arsimimi ushtarak 01110/09430	MM	MB	2020	2022	600	600	0	
11.3	Zhvillimi i programeve kombëtare për sensibilizimin e publikut, institucioneve akademike, subjekteve private, organizatave joqeveritare, për zbatimin e normave, rregullave dhe standardeve ndërkombëtare të regjistrimit, magazinimit dhe ruajtjes së materialeve me përdorim të dyfishtë apo atyre që mund të shërbejnë për prodhimin e ADM-ve	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ arsimimi ushtarak 01110/09430	MM	MB, MEPJ, MSHMS, MASR, MD, MTM, MIE, SHISH	2020	2022	500	500	0	
11.4	Rritja e ndërgjegjësimin të institucioneve akademike dhe komunitetit mbi detyrimet e vendit tonë	Siguria publike/ fushata sensibilizuese K/0342	MM	MB	2020	2022	500	500	0	
11.5	Informimi i publikut të gjerë mbi procedurat e regjistrimit për ruajtjen, transportin, përdorimin apo prodhimin e ligjshëm të mallrave me përdorim të dyfishtë	Siguria publike/ fushata sensibilizuese K/0342	MZHETS, MM, MAS, MFE		2020	2022	500	500	0	
11.6	Aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimin të biznesit mbi rëndësinë e kontrollit të sistemit të eksport-importeve	Siguria publike/ fushata sensibilizuese K/0342	MFE, MM		2020	2022	500	500	0	
11.7	Ngritja e strukturave/pikave të kontaktit për bashkëpunimin me komunitetin akademik, sektorin privat dhe institucionet financiare	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ arsimimi ushtarak 01110/09430	MM	MEPJ, MSH, MB, MASR, MD, MM, MEI, SHISH	2020	2022	16	16	0	



11.8	Hartimi i planeve për zgjerimin e partneritetit me institucione edukative	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi 01110	MEPJ, MASR, MB		2020	2022	16	16	0	
11.9	Fushata publicitare dhe promovuese.	Siguria publike/ fushata sensibilizuese K/0342	MM		2020	2022	1,500	1,500	0	
11.10	Planet dhe metodologjia për informimin e publikut	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ arsimimi ushtarak 01110/09430	MM, MFE	MB	2020	2022	16	16	0	
11.11	Menaxhimi i informacionit	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi/ arsimimi ushtarak 01110/09430	MB		2020	2022	16	16	0	



Lista e indikatorëve/Treguesve të Strategjisë

		INDIKATORI 1	INDIKATORI 2	INDIKATORI 3	INDIKATORI 4	INDIKATORI 5	INDIKATORI 6	INDIKATORI 7	INDIKATORI 8	INDIKATORI 9
1	Emërtimi i indikatorit	Numri i ligjeve dhe i akteve nënligjore që janë hartuar apo përditësuar	Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore, që janë zbatuar me sukses pas miratimit të Strategjisë	Numri i strukturave të krijuara apo rishikuara	Numri i marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale të nënshkruara me shtetet e tjera	Pajisjet e reja për zbulimin dhe gjurmimin e ADM-ve dhe materialeve që mund të përdoren për prodhimin e tyre	Raportet e zbatimit të strategjisë	Modulet mësimore/kurrikulat dhe numri i librave shkollorë, që adresojnë përhapjen e ADM-ve	Numri i personave të dënuar për krime që përfshijnë përhapjen e ADM-ve	Numri i rasteve të trajtuara nga Policia, Prokuroria dhe Gjykatat
2	Lloji i indikatorit	Impakti - Kontribut për sigurinë kombëtare, rajonale, globale	Impakti -Kontribut për sigurinë kombëtare, rajonale, globale	Impakti -Kontribut për sigurinë kombëtare, rajonale, globale	Impakti -Kontribut për sigurinë kombëtare, rajonale, globale	Impakti-Ulja e rrezikut të përhapjes së ADM-së	Rezultati - Përmirësimi i kapaciteteve të ndalimit të përdorimit dhe shpërdarjes së ADM-së	Rezultati - Sensibilizim i të rinjve mbi rrezikun e ADM-së	Impakti - ulja e numrit të personave të përfshirë në përhapjen e ADM-së	Impakti - rritja e gatishmërisë së strukturave shtetërore në parandalimin dhe kapjen e e personave të përfshirë
3	Nr..., datë..., emërtimi i dokumentit	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014	Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligj nr.103/2014, datë 31.7.2014
4	Lidhja me SKZHI-në (Nr. i shtyllës)	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS	2. QEVERISJA E MIRË, DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS
5	Qëllimi/objekti strategjik në SKZHI-në	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar	1.14 Mbrojtje e konsoliduar
6	Qëllimi i politikës korresponduese	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre	Strategjia e M-ADM synon ndalimin e përhapjes së ADM-ve dhe hyrjeve ilegale të materialeve të lidhura me prodhimin dhe përdorimin e tyre
7	Objekti i politikës me të cilin lidhet indikator/treguesi	Plotësimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor sipas nevojës për të garantuar suksesin në ndalimin e hyrjeve ilegale të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërdarjes së tyre.	Konsolidimi i sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë; Forcimi i rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë	Përmirësimi dhe rritja e bashkëpunimit, shkëmbimi i informacionit dhe ndihmës reciproke mbi trafikimin, prodhimin, zotërimin ose përdorimin e ADM-ve, midis: MM (AKSHE), MD, MFE (Doganat) dhe MB (Policia e Shtetit, Policia Kufitare dhe e Emigracionit, Policia Rrugore), institucioneve hetimore dhe Prokurorisë, vendeve të rajonit dhe atyre aleate, si dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.	Përmirësimi dhe zbatimi me rigorozitet i detyrimeve që rrjedhin nga traktatet, konventat dhe memorandumet ndërkombëtare (përfshi edhe embargot dhe kufizimet në kuadër të OKB-së dhe BE-së)	Zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve njerëzore, teknike dhe teknologjike, si dhe zhvillimi i procedurave standarde efektive për parandalimin e përhapjes së ADM-ve	Përmirësimi i politikave dhe vendosja e sistemeve efektive për ndalimin e hyrjes ilegale të ADM-ve, pajisjeve dhe mjeteve të shpërdarjes së tyre në territorin e RSH-së	Përmirësimi i bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe subjektet private, me qëllim zgjerimin e njohurive dhe ndërgjegjësimin e tij	Rritja e numrit të hetimeve efektive dhe të suksesshme në luftën kundër krimit të lidhur me përhapjen e ADM-ve, zotërimin ilegal dhe trafikimin të materialeve apo informacionit, që i shërben prodhimit dhe përdorimit e ADM-ve	Vijimi i rritjes së profesionalizmit të Policisë Kufitare, Policisë së Shtetit dhe punonjësit të doganave, në adresimin e incidenteve që lidhen me trafikimin, përhapjen dhe përdorimin e ADM-ve
8	Përkatësia e indikatorit	Akt ligjor	Akt ligjor	Kuader Politikash	Akt ligjor	Kuader Politikash	Mase zbatuese	Kuader Politikash	Kuader Politikash	Kuader Politikash
9	Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP	Raportet vlerësimi të përgatitura nga DMJP
10	Institucionet përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes
11		Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme,	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme	Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme



		Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë								
12	Përshkrimi i metodologjisë	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Kjo strategji duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet në të gjitha nivelet (qendrore dhe lokale), duke siguruar dhe rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në lidhje me zbatimin e saj	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Kjo strategji duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet në të gjitha nivelet (qendrore dhe lokale), duke siguruar dhe rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në lidhje me zbatimin e saj	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Kjo strategji duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet në të gjitha nivelet (qendrore dhe lokale), duke siguruar dhe rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në lidhje me zbatimin e saj	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Rritje e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikrat e normëzuara ndërkombëtare	Matja e objektivit të përgjithshëm, analizimi i informacionit dhe perdorimin e tij në procesin e vendim-marrjes. Rritje e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikrat e normëzuara ndërkombëtare	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Rritje e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikrat e normëzuara ndërkombëtare	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Rritje e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikrat e normëzuara ndërkombëtare	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Rritje e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikrat e normëzuara ndërkombëtare	Matja e objektivit të përgjithshëm, objektivit specifik shprehur në masa sasiore, cilësore, kohore. Rritje e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, për identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimeve, të lidhura me trafikimin dhe përhapjen e ADM-ve, duke mbështetur dhe duke respektuar edhe standardet dhe praktikrat e normëzuara ndërkombëtare
13	Frekuenca e matjes	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore	Vjetore
14		6-mujore	6-mujore	6-mujore	6-mujore	6-mujore	6-mujore	6-mujore	6-mujore	6-mujore
15	Natyrë e indikatorit/treguesit: kumulativ/ritës	Rritës	Rritës	Rritës	Rritës	Rritës	Rritës	Rritës	Kumulativ	Kumulativ
16	Input direkt ose i përbërë	Input direkt	Input direkt	Input direkt	Input direkt	Input direkt	Input direkt	Input direkt	Input direkt	Input direkt
17	Formula e llogaritjes	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
18	Ndarja e të dhënave (për treguesit e përbërë)	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
19		N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
20		N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
21	Thëksioni drejtimin e ndryshimit/trendit (tendencës) të ecurisë	Rritese	Rritese	Rritese	Rritese	Rritese	Rritese	Rritese	Zbritese	Zbritese
22	Vlerat bazë	2019	2019	2019	2019	2019	2019	2019	2019	2019
23		N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
24	2*Vlera e synuar/targeti	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
25		N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
26		N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
27	*Vlera e synuar/targeti i rishikuar	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
28	3*Vlera aktuale:	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
29	SDG - Titulli i qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm sipas OKB-së	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
30	Vlera e synuar e treguesit të SDG	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A



VENDIM
Nr. 35, datë 22.1.2020

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR
SHËRBIMET ELEKTRONIKE TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të pikave 5, shkronja “ë”, dhe 6, shkronja “e”, të kreut II, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet elektronike në favor të organeve dhe institucioneve të administratës publike dhe subjekteve private ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, kundrejt aplikimit të tarifave përkatëse.

2. Për organet dhe institucionet e administratës publike, shërbimi elektronik për nënshkrim elektronik, vulë elektronike, certifikatë elektronike, transaksion në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG), ofrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me tarifën zero lek.

3. Për subjektet private, shërbimi elektronik për nënshkrim elektronik, vulë elektronike, certifikatë elektronike, transaksion në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG), ofrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me tarifën, si më poshtë vijojnë:

a) 4 800 (katër mijë e tetëqind) lekë, përfshirë TVSH-në, për nënshkrimin elektronik, me afat vlefshmërie 1 vit;

b) 20 (njëzet) lekë, përfshirë TVSH-në, për shërbimin e vulosjes së dokumenteve me vulë elektronike/për transaksion;

c) 4 000 (katër mijë) lekë, përfshirë TVSH-në, për certifikatë elektronike për sistemin fiskal, me afat vlefshmërie 1 vit;

ç) 15 (pesëmbëdhjetë) lekë, përfshirë TVSH-në, për transaksion në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG).

4. Pagesa e tarifave kryhet nga subjektet private në momentin e aplikimit *online* për kryerjen e veprimeve dhe të procedurave, nëpërmjet pagesës elektronike në portalin *e-Albania*.

5. Të ardhurat e realizuara derdhen 100% në buxhetin e shtetit, në përputhje me vendimin nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijohen nga institucionet buxhetore”.

6. Vendimi nr. 15, datë 12.1.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet elektronike të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 37, datë 22.1.2020

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCave DHE EKONOMISË, SI
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “SV
MEGA” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR
PASURITË SHTETËRORE NR. 1/82, ME
SIPËRFAQE TOTALE 554 m² DHE NR.
1/83, TRUALL I LIRË ME SIPËRFAQE
TË PËRGJITHSHME 4246 m², ZONA
KADASTRALE 2646, PJESË E STACIONIT
HEKURUDHOR TË LIBRAZHIT, E
PËRBËRË NGA DY PASURI, NË
ADMINISTRIM TË SHOQËRISË
“HEKURUDHA SHQIPTARE”
SHA, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për



përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “SV Mega” sh.p.k., si qiramarrës, për pasuritë nr. 1/82, me sipërfaqe totale 554 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 34 m² dhe sipërfaqe funksionale 520 m² dhe nr. 1/83,

trull i lirë me sipërfaqe të përgjithshme 4246 m², zona kadastrale 2646, në total sipërfaqe të përgjithshme 4 800 m², pjesë e stacionit hekurudhor të Librazhdit, në administrim të shoqërisë “Hekurudha shqiptare” sh.a., Durrës, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË**

Nr. ____ Rep.

Nr. ____ Kol.

**DRAFTKONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata**

Lidhur në Tiranë, sot, në datën _____, të muajit _____, të vitit (); u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijnë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. _____ prot., datë _____, nga z. Arian Kraja, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes 10.8.1965, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, i pajisur me kartën e identitetit me nr. personal: G50810164E, që më poshtë do të quhet **“Qiradhënësi”**

DHE

Shoqëria “SV Mega” sh.p.k., me seli qendrore në _____, me adresë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: L51314509P, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. Altin Kumara, i datëlindjes, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimi personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet **“Qiramarrësi”**.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me propozimin nr. 221/8, datë 9.7.2019, të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar, pas konkurrimit të zhvilluar në datën 8.8.2019, në zbatim të urdhrit nr. 283, datë 23.7.2019, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, shpalli fitues subjektin “SV Mega” sh.p.k.; të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si Qiradhënësi dhe shoqërisë “Sv Mega” sh.p.k. si Qiramarrësi, për pronën shtetërore, “Pjesë e stacionit hekurudhor të Librazhdit, e përbërë nga dy pasuri: pasuria nr. 1/82, me

sipërfaqe totale 554 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 34 m² dhe sipërfaqe funksionale 520 m² dhe pasuria 1/83, truall i lirë, me sipërfaqe të përgjithshme 4246 m², ZK. 2646, në total, sipërfaqja e përgjithshme 4800 m²”, në administrim të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës”, bazuar në nenet 801–825, të Kodit Civil, së bashku me “Qiramarrësin”, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë.

Neni 1**Objekti i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore, “Pjesë e stacionit hekurudhor të Librazhdit, e përbërë nga dy pasuri: pasuria nr. 1/82, me sipërfaqe totale 554 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 34 m² dhe sipërfaqe funksionale 520 m² dhe pasuria 1/83, truall i lirë, me sipërfaqe të përgjithshme 4246 m², ZK. 2646, në total, sipërfaqja e përgjithshme 4800 m²”, në administrim të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës, sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP-së Librazhd, nr. 3557 prot., datë 9.10.2018.

Neni 2**Qëllimi i përdorimit**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm të objektit të përcaktuar në nenin 1, për ndërtimin e një kabanoni të ri me sipërfaqe rreth 1600 m², në të cilën do të montohen makineritë dhe pajisjet të cilat do të shërbejnë në funksion të prodhimit, përpunimit, rifinimit, bashkimit, shitjen e tregtimit e aksesoreve e komponentëve të autoveturave dhe mjeteve lundruese, si dhe arredimin me lëkurë, copë dhe materiale të tjera nëpërmjet autorizimit për përdorimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv.

Neni 3**Kohëzgjatja**

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.



Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 Qiradhënësi, nëpërmjet shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës, si njësi që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Qiramarrësit.

4.3 Qiradhënësi ka të drejtë, që, në çdo kohë, gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 Qiradhënësi është i detyruar të garantojë Qiramarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë, që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që për zhvillimin e aktivitetit, të jetë i pajisur me Autorizimin për Përpunimin Aktiv të Mallrave, lëshuar prej

institucioneve shtetërore, aktualisht, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Një kopje e autorizimit, si dhe, gjithmonë kur ai përsëritet, duhet të paraqitet edhe te Qiradhënësi.

5.4 Qiramarrësi detyrohet që në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.5 Qiramarrësi detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.6 Qiramarrësi detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.7 Qiramarrësi detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.8 Qiramarrësi, shoqëria “SV Mega” sh.p.k., sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim do të investojë për zgjerimin e aktivitetit të saj, nëpërmjet ngritjes në qytetin e Librazhdit të linjës së re për prodhimin, përpunimin, rifinimin dhe bashkimin e aksesoreve dhe komponentëve për autovetura dhe mjete lundruese, produkte të cilat kanë si destinacion eksportin e tyre.

Shoqëria, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe e nxjerrjes së lejeve përkatëse do të investojë në total rreth 41 (dyzet e një) milionë lekë (pa TVSH), të ndara si më poshtë:

- investimi që do të kryhet për punime e ndërtime në vlerën 40 milionë lekë;
- investime lidhur me transportin dhe montimin e makinerive të cilat kompania i ka gjendje të aktivitetit ekzistues të shoqërisë në vlerën 1 (një) milion lekë.

Sipas planbiznesit, investimi që do të kryhet në pasurinë shtetërore konsiston:

- ndërtimin e një kabanoni të ri me sipërfaqe rreth 1600 m², duke përfshirë edhe ambientet për zyrat;
- ndarjen e ambienteve të brendshme, sipas sektorëve të procesit teknologjik, që do të aplikohet në pjesën e brendshme të repartit;
- shtresa e suvatime për të gjithë ambientet, dritare me duralumin termik, punime rifiniture të brendshme e të jashtme etj.;
- krijimin e ambienteve sociale dhe të shërbimit për punonjësit, si dhe kompletimi i tyre;
- kryerjen e punimeve për shtrimin e linjave hidraulike dhe elektrike në të gjithë ambientin, në



përputhje edhe me procesin teknologjik të prodhimit;

- sistemimin dhe shtrimin e gjithë ambientit tjetër të jashtëm, si dhe krijimi në pjesën fundore të një ambienti të veçantë që punonjësit të qëndrojnë në periudhën e pushimit;

- mbjelljen e pemëve dhe krijimi i disa ambienteve me lulishte në pjesën e rrethimit për krijimin e një mjedisi çlodhës e për një kontribut modest në ndikimin pozitiv në mjedis;

- rrethimi i objektit që është parashikuar të bëhet me brez betoni dhe kangjella;

- punime të tjera të paparashikuara.

Vlera 12 milionë lekë e makinerive që do të transferohen nga aktiviteti i shoqërisë nuk do të përfshihen në vlerën e investimit.

Investimi do të realizohet në një fazë e cila do të zgjasë 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe marrjes së lejeve përkatëse nga institucionet shtetërore dhe pushteti lokal.

Burimi i financimit të projektit për investimet do të bëhet nga fondet e vetë shoqërisë, të cilat rrjedhin nga aktiviteti ekonomik-financiar i shoqërisë.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përlllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë, gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.9 Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim merr përsipër, që **të punësojë minimalisht 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës brenda 3 vjetëve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse.**

Organizimi i punësimit parashikohet të realizohet në dy faza:

Faza e parë, që përfshin periudhën 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe e nxjerrjes së lejeve përkatëse (paralelisht me investimin); numri i të punësuarve në repartin e Librazhdit do të jetë 30 punonjës të rinj.

Faza e dytë, që përfshin periudhën 12 muaj nga përfundimi i fazës së parë të punësimit, pas futjes së repartit të ri me kapacitet të plotë; numri i të punësuarve në repartin e Librazhdit do të shtohet edhe me 25 punonjës të rinj.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përlllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë, gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.10 Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi, “Për përcaktimin e pagesë minimale në shkallë vendi”.

5.11 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit në territorin objekt të kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.8 dhe 5.9, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedimore nga organet kompetente.

5.12 Qiramarrësi detyrohet që para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate.

5.13 Qiramarrësi detyrohet që, nëpërmjet shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., të paraqesë te Qiradhënësi në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.14 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.15 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga Qiramarrësi.

5.16 Në ngarkim të Qiramarrësit janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.17 Qiramarrësit nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira ta japë me, nën qira ose t’ia kalojë kontratën një tjetri.

5.18 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt të kësaj kontrate, në



realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.8 dhe 5.9, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.19 Qiramarrësi, në asnjë rast, nuk mund ta rëndojë me barrë pronën objekt kontrate.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë Qiradhënësit detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata, sipas faturës të lëshuar nga Qiradhënësi.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës Qiramarrësi ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 820 000 (tetëqind e njëzet mijë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga Qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.8 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, Qiramarrësi do të likujdojë vlerat e krijuara në llogarinë e Qiradhënësit, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur Qiramarrësi, sipas përcaktimeve në pikën 5.8 të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe gjobit Qiramarrësin, me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur Qiramarrësi, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.9, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
 - b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
 - c) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 të kësaj kontrate;
 - d) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.8 të kësaj kontrate;
 - d) kur Qiramarrësi ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata;
 - e) kur prona nevojitet për interes publik;
 - f) kur prona kalon në procedurë privatizimi;
 - g) kur Qiramarrësi nuk pajiset me autorizim për përpunim aktiv të mallrave ose rifreskimit të tij, për një periudhë mbi 5 (pesë) muaj;
 - k) kur prona nevojitet për një investim të mundshëm në sistemin hekurudhor. Kontrata do të zgjidhet pa penalitet për entin pronar shtetëror.
- 8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe, nëse Qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga Qiramarrësi, sipas pikave 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës, për nivelin e investimeve dhe të punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, Qiramarrësi dhe shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a., Durrës, Tiranë, janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose të gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do



të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10

Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe, në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen Qiramarrësit.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e në vijim, të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Përfaqësuar nga

QIRAMARRËSI

Shoqëria "Sv Mega" sh.p.k.
Përfaqësuar nga

VENDIM

Nr. 38, datë 22.1.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.699, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'BY-PASS VLORE' (SHTESA)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, me këtë përmbajtje:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall", "arë", "kullotë", "pyll" dhe "drufrutorë", me vlerë të përgjithshme 245 827 297 (dyqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, si më poshtë vijon:

- truall, me sipërfaqe 22 141 (njëzet e dy mijë e njëqind e dyzet e një) m², me vlerë 230 691 978 (dyqind e tridhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë;

- arë, me sipërfaqe 55 316 (pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) m², me vlerë 11 284 464 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër);

- kullotë, me sipërfaqe 11 800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) m², me vlerë 2 360 000 (dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;



- pyll, me sipërfaqe 4 187 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², me vlerë 690 855 (gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë);

- drurë frutorë, me vlerë 800 000 (tetëqind mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “kullotë” “pyll” dhe “drurë frutorë”, në shumën 245 827 297 (dyqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 234 237 718 (dyqind e tridhjetë e katër milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

- 11 589 579 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohen si më poshtë vijon:

- 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, nga Autoriteti Rugor Shqiptar;

- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

b) Pas tabelës bashkëlidhur vendimit shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 699, DATË 05.10.2016, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “BY-PA SS VLORE (SHITESA)”

NR.	PRONARI			Zona Kadastrale	Numër Pasuric	Lloji i pasurisë	Dru Frutorë Vlera në lekë	Sip. totale (m²)	Sip. Shpronësimit						Vlefë (lekë/m²)	Vlefë totale (lekë)	Adresa	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						ARË (m²)	ULLISHTË (m²)	VRESHT (m²)	KULLOTË (m²)	PEMETORE (m²)	PYLL (m²)				
1	VERO		HARAPAJ	2074	160/20	ULLISHTË		4200.0		1520					204	310,080	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
2	VIKTOR		BESHAI	2074	160/17	ULLISHTË		930.0		920					204	187,680	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
3	VIKTOR		BESHAI	2074	152/6	ULLISHTË		2820.0		1014					204	206,856	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
4	VULLNET		MINGAJ	2074	564/2	ULLISHTË		550.0		61					204	12,444	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
5	NUMAN		LAZAJ	2074	564/7	ULLISHTË		3100.0		1208					204	246,432	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
6	BP LAZAJ			2074	564/12/1	ULLISHTË		3500.0		1237					204	252,348	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
7	BP FEJZAJ, BELAJ ETJ			2074	553/6	ULLISHTË		4000.0		247					204	50,388	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
8	NOVRUS		ISUFAT	2074	135/1	ARË		4200.0	119						204	24,276	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
9	ANDON		ZANAJ	2074	564/1	ULLISHTË		500.0		56					204	11,424	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
10	ARKIMET		BEGAJ	2074	373/6	VRESHT		6400.0			1532				204	312,528	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
11	HAXHI		BEGAJ	2074	373/19	ARË		2000.0	493						204	100,572	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
12	BP GABA			3621	644	KULLOTË		17000.0				225			200	45,000	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
13	DRETOI		RAMOHITAJ	3621	180/14	ARË		2000.0	126						204	25,704	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
14	DREJTOJ		RAMOHITAJ	3621	180/15	ARË		6360.0	18						204	3,672	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
15	RITA		GJONI	3621	180/13	ARË		2000.0	92						204	18,768	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
16	ESAT		RAMOHITAJ	3621	47/6/1	ARË		8000.0	1875						204	382,500	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
17	BP HAMITI			3140	177/1	VRESHT		7879.0			1031				204	210,324	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
18	TRASHGIMTARET HADER SELMANAJ			3140	177/2	VRESHT		14039.0			2704				204	551,616	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
19	BP DERVISHI			3140	177/3	VRESHT		5212.0			1237				204	252,348	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
20	BP ALIKO, ÇAKERRI ETJ			8605	56/135	PEMETORE		840.0					220		204	44,880	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
21	GENTIAN	BRAHIM	MEZANI	8605	56/132	PEMETORE		1600.0					195		204	39,780	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
22	BP KILI, DINE ETJ			8605	56/42	ULLISHTË		4764.0		1090					204	222,360	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
23	MUÇO		XHUVELI	3621	124	KULLOTË		1042.5				102			200	20,400	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
24	KASTRIOT		HOXHA	2074	887/1	ULLISHTË		2500.0		469					204	95,676	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë



25	BP ZOTAJ SHEHU ETJ			8602	41/460	KULLOTË		102023.8				4527			200	905,400	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
26	LUAN	EJUP	ZOTAJ	8602	41/461	KULLOTË		11336.0				329			200	65,800	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
27	BP RRAPI			8602	41/462	KULLOTË		17003.9				495			200	99,000	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
28	LULEZIME		GJONDEDA	8602	41/463	KULLOTË		17003.9				933			200	186,600	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
29	ARBEN	QIRIO	MEKSI	8602	41/464	KULLOTË		17003.9				1559			200	311,800	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
30	QERIBA	RUSHIT	GJIKA	8602	41/465	KULLOTË		17003.9				3481			200	696,200	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
31	BP LIMAJ			2074	933/1	ULLIShte		2260.0		559					204	114,036	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
32	LIÇO		TESHAJ	2074	727/3	ULLIShte		7720.0		2356					204	480,624	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
33	KIMET	BATJAR	HOXHAJ	2074	887/5	ULLIShte		670.0		443					204	90,372	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
34	B/P BISHA			8605	8/237	ULLIShte	290,000	8000		307					204	352,628	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë dhe nga Drejtoria e Bujqësisë Vlorë
35	B/P KOÇI, LOSHI ETJ			8605	56/117	ULLIShte		2850		19					204	3,876	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
36	JOLANDA		PICI	8605	56/70	ULLIShte		5100		493					204	100,572	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
37	B/P JANKA, ALIMERKO			8605	61/6	ULLIShte		20000		5253					204	1,071,612	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
38	YDAI	VERO	BRATI	2074	140/1	ARË		5400	1683						204	343,332	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
39	B/P MERSINI, AGALLIU ETJ			8605	56/85	ULLIShte	510,000	13250								510,000	BASHKIA VLORE	Konfirmuar Drejtoria e Bujqësisë VlorëSiperfaqja e tokës e shpronësuar me VKM NR.699 05.10.2016
40	IMER		MERKAJ	2074	160/11	ULLIShte		6000		1609					204	328,236	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
41	AVDUL		METUSHAJ	2074	160/15	ULLIShte		4400		851					204	173,604	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
42	HAMZA	NAMIK	DERAJ	2074	161	ARË		5600	687						204	140,148	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
43	NIAZI		HASANAJ	2074	160/8	ULLIShte		5000		1372					204	279,888	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
44	NIAZI	ISUF	HASANAJ	2074	160/9	ULLIShte		5500		660					204	134,640	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
45	XHEMIL		HAMZAJ	2074	152/4	ULLIShte		4300		2538					204	517,752	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
46	JETOSH		BEGAJ	2074	373/17	ARË		3100	1565						204	319,260	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
47	MERITA		GOLEMAJ	2074	373/27	ARË		500	222						204	45,288	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
48	AZEM DALAN SELMANAJ DHE TRASHGIMTARET			3140	175/9	PYLL		14050						4187	165	690,855	BASHKIA VLORE	Konfirmuar nga A.SH.K. Vlorë
Vleta e shpronësimit									6,880.00	24,282	6,504	11,651	415	4,187		11,589,579		

**VENDIM****Nr. 39, datë 22.1.2020****PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 452, DATË 27.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E VARREZAVE PRIVATE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ‘PASKUQAN’, QARKU TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 452, datë 27.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e varrezave private në njësinë administrative “Paskuqan”, Qarku Tiranë”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 40, datë 22.1.2020****PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 56/50, ZONA KADASTRALE 2946, BASHKIA PËRMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 56/50, zona kadastrale 2946, Bashkia Përmet, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Gjirokastrë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 56/50, zona kadastrale 2946, Bashkia Përmet.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1076866
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit 7 V.R.P.P. PËRMET Zona Kadastrale N946
 Numri i Pasurisë 56/50 Volumi 1 Faqe 1
 Adresa e Pasurisë PËRMET
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 642.00 m²
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)	Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
DORIAN	STILIANO	NIKOLLA	1/2	TIRANE	
ENDRI	PËLLUMB	XHAFERAJ	1/2	TIRANE	
_____	_____	_____	_____	_____	
_____	_____	_____	_____	_____	
_____	_____	_____	_____	_____	

- është pronar i _____ tek pasuria me numër 56/50
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) Interesuari (t)
 më datë 15/11/2018 Nr 197

Data e lëshimit të çertifikatës
15/12/2018

Lëshuesi i çertifikatës
 REGJISTRUESI
 (VASIL PANO)



HARTE TREGUESE E REGJISTRIMIT

Fragment

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE
PASURIVE TE PALUAJTSHME PERMET

REGJISTRUESI

Vasil PANO

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE


ZONA KADASTRALE 2846 Nr. i pasurise 56/50 V. 1 Fq. 81INDEKSI I HARTES K-34-137-(94-C) SHKALLA 1:2500ADRESA E PASURISE Rrethi Permet Q. / F PETRAH

RR/L _____ P/G. _____ Shk _____ K _____ Ap/NJ _____

B. KUFIZIMET

V. 56/13L. 56/49I. 56/51P. 56/63

C. PRONARI/ET

ENBRI XHA FERATDORIAN NIKOLLADATA 13/11/2018 Ora _____ Nr. Kerkeses 1197



v. K. M. Nr. 519, Datē 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 1, Fq. 81

IONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

zona Kadastrale: 2946 NR.i PASURISE : 56/50

--> Vijn nga: Vol. _____, Fq. _____

Indeksi Hartes: -K-34-137-(94-C)

Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____ -->

Adresa e Pasurisë: Rrethi PËRMET Q/F PERMET

PERFUNDIMTARE (data): _____

Rr/L _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____

Përshkrim i veçantë:

B-SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: **ARE** Brenda V.K.N. : **JO** , Ref : _____

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Truall: sa Ndërtësi	Per pjesen e përbashkët: PALLAT Kuota e pjesëmarrjes: _____ % Nr i Pasurise (pallat): _____ Vol. _____ Faqe _____
1. <u>577.00</u> m ² Ref. <u>AKT2522</u>	1. _____ m ² Ref. _____	1. _____ m ² Ref. _____	
2. <u>642.00</u> m ² Ref. <u>LN KORRIK</u>	2. _____ m ² Ref. _____	2. _____ m ² Ref. _____	
3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	
4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	

C- SEKSIONI I PRONESISE

[illegible]

Qeydlər: Kallans I/E/D təqəss: I - individ, nərson fizik oşə inridik; F - nərfağəsues i families; B - bəshkəpnər (%)



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË**

**ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Adresa: Rruga 11 Nentori, Laji, Brigada 17 S (prane Prefektures)

PËRMET, me 15 /12 2018

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë

Në regjistrin Vol 1, Faqe 81, Zona Kadastrale 2946, Qyteti Përmet

REGJISTRUESI

VASIL PANO



Lidhja nr. 1

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në m ²	Sipërfaqja që përdoret për zhvillim m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Gjirokastrë	Përmet	2946	Petran	56/50	642 m ²	335 m ²	150 m ²	Agroturizëm 2-katësh, me funksion bujtinë me mbarështim shpendësh

VENDIM
Nr.42, datë 22.1.2020

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, dhe të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve, dhënë në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr.9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim global për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxheti global detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

c) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon spitalet, në zbatim të vendimit nr.258, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kontratës së koncensionit/partneritetit publik privat “Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës””. Fondi rishikon financimin e spitaleve për këtë kontratë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ, me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe/ose të strukturës së saj përgjegjëse.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.



9. Një fond jo më i madh se 32% e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

- a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;
- b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- d) pagesa të shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për partneritetin publik privat;
- dh) transfera për individët (mjekë specialistë).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. Spitalet universitare e paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet tërësisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime dhe investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

14. Mënyra e pagesës dhe e shpërbllimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë

me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij vendimi, përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj dhe për raste të tjera me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

16. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor kontrollojnë, monitorojnë buxhetin spitalor, vlerësojnë aktivitetin vjetor të spitaleve dhe treguesit e performancës nëpërmjet strukturave të tyre audituese dhe kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e financimit. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor monitoron dhe vlerëson performancën e punonjësve të spitaleve rajonale dhe bashkiake, sipas treguesve të kontratës së financimit.

17. Marrëdhëniet juridike të punës në spitale rregullohen në përputhje me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 12 016 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë) veta, nga të cilët 141 (njëqind e dyzet e një) punonjës në Spitalin Universitar të Traumës për Shërbimin e Urgjencës Ambulatore dhe Shërbimin e Ortopedi-Traumatologjisë. Numri dhe struktura e punonjësve për çdo spital miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

19. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, sipas nevojave. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr.77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe



përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

20. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 19, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

21. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i spitalit.

22. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

23. Vendimi nr.46, datë 30.1.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2020.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË
DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë;

a) Hemodinamika;

b) Reanimacioni i kardiologjisë.

2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezisë-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencave polivalente;
10. Shërbimi i hipertonsisë dhe mjekësisë interne;
11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë (SU “Trauma”);
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20. Shërbimi i kirurgjisë digjestive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë;
24. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë;
27. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
28. Shërbimi i pediatriisë së specialiteteve;
29. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
30. Shërbimi i pediatriisë infektive;
31. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatriisë së përgjithshme;
32. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
33. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
34. Shërbimi i laboratorëve (klinikë – biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laborator i mjekësisë nukleare);
35. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
36. Shërbimi i fizioterapisë;
37. Shërbimi i statistikave;
38. Shërbimi i pneumologjisë;
39. Kirurgjia torakale;
40. Shërbimi i ftiziatriisë;
41. Shërbimi i gjinekologjisë;
42. Shërbimi i obstetrikës;
43. Shërbimi i patologjisë së barrës;
44. Shërbimi i neonatologjisë;
45. Shërbimi i farmacisë;



46. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;

47. Shërbimi i toksikologjisë klinike;

48. Shërbimi i psikiatrisë (QSUT);

49. Kontrolli i infeksioneve spitalore;

50. Shërbimi i urgjencës ambulatorë.

II. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;

1. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;

2. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologjisë, urologjisë, ORL,

okulistikës, angiologjisë, max-facial;

3. Shërbimin e obstetrikë-gjinekologjisë;

4. Shërbimin e neonatologjisë;

5. Shërbimin e pediatriës;

6. Shërbimin e radiologjisë;

7. Shërbimin e fizioterapisë;

8. Shërbimin e anatomisë dhe histologjisë patologjike;

9. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë e të mikrobiologjisë;

10. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;

11. Shërbimin e farmacisë;

12. Shërbimin e onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);

13. Kontrollin e infeksioneve spitalore;

14. Shërbimin psiko-social;

15. Shërbimin e konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);

16. Bankën e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:

1. Shërbimin e urgjencës;

2. Shërbimin e mjekësisë së përgjithshme;

3. Shërbimin e kirurgjisë së përgjithshme;

4. Shërbimin e pediatriës dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;

5. Shërbimin e radiologjisë;

6. Shërbimin e laboratorëve kliniko-biokimikë e të mikrobiologjisë;

7. Shërbimin e anestezi-reanimacionit;

8. Shërbimin e farmacisë;

9. Shërbimin ambulator i specializuar;

10. Bankën e gjakut.

Trajtimi i kimioterapisë do të ofrohet nga shtatë spitale: Spitali i Durrësit, Spitali i Vlorës, Spitali i Shkodrës, Spitali i Korçës, Spitali i Lezhës, Spitali i Fierit dhe Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”.

SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.

SHTOJCA NR.2 BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2020

Nr	INSTITUCIONI	Buxheti (000leke)					Totali
		600	601	602	604	rezervë	
1	BERAT	258,000	43,000	162,000			463,000
2	BULQIZË	71,300	11,900	30,000			113,200
3	DELVINË	33,000	5,500	5,500			44,000
4	DEVOLL	45,000	7,500	10,000			62,500
5	DIBËR	232,000	38,740	110,000			380,740
6	ELBASAN	390,000	65,000	220,000			675,000
7	FIER	345,500	57,850	230,000			633,350
8	GRAMSH	105,000	17,500	36,000			158,500
9	GJIROKASTËR	185,000	30,800	80,000			295,800
10	HAS	40,500	6,750	12,000			59,250
11	KAVAJË	98,600	16,400	28,000			143,000
12	KOLONJË	78,000	13,000	20,000			111,000
13	KORÇË	374,000	62,400	185,000			621,400



14	KRUJË	109,000	18,200	26,000			153,200
15	KUÇOVË	62,000	10,300	15,000			87,300
16	KUKËS	229,700	38,350	100,000			368,050
17	KURBIN	74,000	12,400	29,000			115,400
18	LEZHË	220,000	36,700	112,000			368,700
19	LIBRAZHD	131,000	21,800	50,000			202,800
20	LUSHNJË	203,000	33,900	100,000			336,900
21	MALËSI E MADHE	22,000	3,650	6,000			31,650
22	MALLAKASTËR	40,000	6,680	11,000			57,680
23	MAT	112,000	18,700	35,000			165,700
24	MIRDITË	92,000	15,350	25,000			132,350
25	PEQIN	34,000	5,650	5,500			45,150
26	PËRMET	75,300	12,550	35,000			122,850
27	POGRADEC	148,700	24,800	70,000			243,500
28	PUKË	86,000	14,350	30,000			130,350
29	SARANDË	137,900	23,000	95,000			255,900
30	SKRAPAR	75,000	12,500	16,000			103,500
31	SHKODËR	483,700	80,750	190,000			754,450
32	TEPELENË	83,200	13,900	16,000			113,100
33	QSUT	1,900,000	317,300	2,800,000			5,017,300
34	SUOGJ "MBRETËRESHA GERALDINË"	270,000	45,000	270,000			585,000
35	SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	225,000	37,500	160,000			422,500
36	SU "SHEFQET NDROQI"	309,000	53,700	310,000			672,700
37	SU TRAUMA	115,000	19,200	140,000			274,200
38	TROPOJË	93,700	15,640	30,000			139,340
39	VLOREË	367,100	61,300	300,000			728,400
	Paketat e shërbimeve				3,175,080		3,175,080
	Trajtime me VKM				30,000		30,000
	Transferta për individët (mjekë specialistë)				30,000		30,000
	Pagesa të shërbimeve PPP				3,293,000		3,293,000
	Rezerve					225,424	225,424
	TOTALI	7,954,200	1,329,510	6,105,000	6,528,080	225,424	22,142,214

SHTOJCA NR. 3

LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;
4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riaftësimit, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.



URDHËR
Nr. 14, datë 16.1.2020

**PËR SHPALLJEN E “THIRRJES SË
PESTË” NË KUADËR TË PROGRAMIT
KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË
PUNËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6 të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e “Thirrjes së pestë”, në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës me mbështetjen e institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, institucioneve të tjera publike, njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe shoqërive tregtare brenda muajit shkurt 2020.

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, për vitin 2020, do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë të bëjë koordinimin ndërinstitutional të programit, në përputhje me metodologjinë bashkëlidhur këtij urdhri, me institucionet që paraqesin interes.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Besa Shahini

**METODOLOGJIA DHE PLANI
I VEPRIMIT**

**NË KUADËR TË PROGRAMIT
KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS,
“THIRRJA E PESTË”**

Në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.

1. Puna përgatitore për planifikimin e nevojave:

a) institucionet e përfshira në këtë program u komunikojnë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe Departamentit të Administratës Publike (DAP) personat e kontaktit për programin, numrin e praktikantëve dhe profilet e tyre studimore;

b) MASR-ja është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e databazës për të gjitha institucionet e përfshira në program;

c) MASR-ja përgatit materialet për publikim në platformën *online*: praktika.arsimi.gov.al;

d) MASR-ja mban komunikimin me personat e kontaktit të të gjitha institucioneve të përfshira në program;

e) ministritë, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare, nëpërmjet personave të kontaktit të konfirmuar, organizojnë dhe udhëzojnë institucionet dhe njësitë në varësi, në lidhje me tërësinë e procesit të zhvillimit të programit.

2. Përgatitja dhe shpallja e procesit të aplikimit:

a) krijimi i platformës *online* për aplikim: praktika.arsimi.gov.al;

b) shpallja e thirrjes realizohet nga MASR-ja, me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera bashkëpunuese;

c) shpallja e thirrjes u dërgohet institucioneve, të cilat kanë për detyrim ta publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe mediet sociale;

d) procesi i aplikimit fillon në datën 7 shkurt 2020 dhe përfundon në 29 shkurt 2020;



e) ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka të drejtë të zgjasë afatin e aplikimit.

3. Kriteret e aplikimit:

a) aplikantët duhet të kenë mbushur 21 vjeç deri në datën 9 mars 2020, si dhe të jenë deri në 26 vjeç në datën 9 mars 2020 (fillimi i programit të praktikës);

b) aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë *Bachelor*, deri në datën 9 mars 2020;

c) aplikantët nuk duhet të kenë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme, pasi qëllimi i tij është ofrimi i një përvojë kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale e të shprehive të tyre praktike, në njohje me sistemin administrativ publik.

4. Kohëzgjatja e programit:

a) Programi Kombëtar i Praktikës së Punës, “Thirrja e pestë”, do të zgjasë 3 (tre) muaj;

b) programi fillon më datën 9 mars 2020 dhe përfundon më datën 9 qershor 2020.

5. Procesi i aplikimit:

a) aplikimi kryhet në platformën zyrtare të programit: <http://praktika.arsimi.gov.al/>;

b) në platformën e aplikimit publikohen profilet studimore të kërkuara nga institucionet pjesëmarrëse në program, me qëllim orientimin e kandidatëve.

6. Format i aplikimit

Në formatin e aplikimit kërkohen të dhënat, si më poshtë:

a) studimet e fundit të përfunduara;

b) përcaktimi i mesatares së studimeve të fundit të përfunduara, me të cilat aplikanti po kandidon;

c) jetëshkrimi dhe letra e motivimit, në të cilën kërkohet të shpjegohet se si kjo praktikë në institucionin përkatës do të ndikonte në rritjen e tij/saj profesionale.

7. Fushata e komunikimit për “Thirrjen e pestë”:

a) institucionet pjesëmarrëse në program bashkëpunojnë për publikimin e thirrjes së pestë të programit;

b) MASR-ja organizon takime informuese me studentë, të rinj, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë.

8. Ngritja e komisioneve përzgjedhëse:

a) institucionet pjesëmarrëse ngrenë komisionet përzgjedhëse përpara mbarimit të afatit të aplikimit;

b) institucionet përcaktojnë nëse njësitë nën varësi ngrenë komisione përzgjedhëse apo përzgjedhja realizohet nga vetë institucioni, nga i cili kanë varësi; mbështetur në kërkesat e profileve studimore të deklaruara;

c) komisioni është i përbërë nga minimalisht 3 (tre) persona;

d) personi kontakt i institucionit është anëtar;

e) nëpërmjet personave kontakt të konfirmuar, organizojnë dhe udhëzojnë institucionet dhe njësitë nën varësi, në lidhje me tërësinë e procesit të ngritjes së komisioneve.

9. Komunikimi i aplikimeve:

a) MASR-ja u dërgon në format elektronik aplikimet personave të kontaktit të programit, për sistem ministror apo bashkiak, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike;

b) ministritë, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare dërgojnë elektronikisht aplikimet në personat e kontaktit të institucioneve dhe njërive që kanë vartësi dhe në të cilat janë ngritur komisione përzgjedhëse.

10. Përzgjedhja e kandidatëve fitues

- Vlerësimi kryhet si më poshtë:

a) vlerësimi maksimal është 40 pikë.

I. Vlerësimi për nivelin e diplomës:

- *Bachelor* 5 pikë;

- Master profesional 10 pikë;

- Master shkencor 15 pikë.

II. Vlerësimi për mesataren e notave:

5–6 5 pikë;

7–8 10 pikë;

9–10 15 pikë.

III. Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;

b) përzgjedhja e kandidatëve mbështetet në profilet studimore të kërkuara nga institucioni, të cilat shpallen në platformën e aplikimit për “Thirrjen e pestë”;

c) komisioni harton listën me kandidatët, sipas renditjes së pikëve, ndarë sipas profileve studimore;

d) komisioni shpall listën fituese, sipas profileve studimore;

e) komisioni harton listën e kandidatëve në pritje.

11. Lajmërimi i fituesve:

a) institucioni pjesëmarrës në program është përgjegjës për lajmërimin e fituesve;



b) fituesit lajmërohen mbi datën e paraqitjes në institucion dhe dokumentacionin që duhet të dorëzohet në institucionin ku kryhet programi;

c) institucionet e përfshira në program dërgojnë elektronikisht pranë MASR-së dhe Departamentit të Administratës Publike, emrat e praktikantëve që rezultojnë fitues të procesit të përzgjedhjes për çdo thirrje, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të këtij procesi, sipas formatit dhe të dhënat e përcaktuara nga MASR-ja;

d) shpallja e fituesve bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga mbyllja e aplikimit;

e) ankimimet bëhen brenda 3 ditëve nga shpallja e fituesve.

12. Procesi i rishpërndarjes:

a) në rast se institucioni nuk plotëson vendet e kërkuara me aplikimet e marra, mund të kërkojë kandidatë nga institucionet brenda të njëjtit sistem ministror, bashkiak apo të biznesit, si dhe mund të kërkojnë nga aplikimet e tjera, sipas sistemeve përkatëse;

b) koordinimin e rishpërndarjes e realizon personi kontakt i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

13. Angazhimi i praktikantit në orë pune:

a) praktikanti do të kryejë praktikën e punës pranë institucionit ku është pranuar, çdo ditë, nga e hëna deri të premten, orar zyrtar;

b) praktikanti, që të certifikohet për përfundim me sukses të programit, duhet të ketë marrë pjesë minimalisht në 80% të periudhës së zhvillimit të programit.

14. Fillimi i programit:

a) kandidati fitues dorëzon te personi kontakt në institucion, jo më vonë se 10 ditë, pasi ka filluar programin: jetëshkrim, fotokopje ID, kopje e noterizuar e listës së notave të studimeve të përfunduara, kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të përfunduara;

b) personi kontakt në çdo institucion konfirmon të dhënat e deklaruara në aplikim;

c) në qoftë se kandidati ka bërë deklaram të rremë nuk kualifikohet;

d) në rast skualifikimi apo të tërheqjes nga programi të një kandidati, personi kontakt i programit përzgjedh të renditurin në radhë, me të njëjtin profil studimor, me pikët më të larta për atë institucion, sipas listës së pritjes së hartuar nga komisioni;

e) pas konfirmimit të të dhënave, nënshkruhet marrëveshja midis institucionit ku kryhet praktika dhe praktikantit, brenda 14 ditësh kalendarike nga fillimi i programit;

f) marrëveshja tip hartohet nga MASR-ja;

g) personi kontakt në çdo institucion koordinon procesin e përcaktimit të një mbikëqyrësi për secilin praktikant, i cili përmbush kriteret dhe detyrat e përcaktuara në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, pika 8 dhe 9.

15. Përfundimi i programit për “Thirrjen e pestë”:

a) hartohen nga MASR-ja formularët e vlerësimit për praktikantët nga mbikëqyrësit dhe formularët e vlerësimit të praktikantëve për mbikëqyrësit;

b) javën e fundit të zhvillimit të programit plotësohen formularët e vlerësimit nga mbikëqyrësi për praktikantët dhe nga praktikantët për mbikëqyrësit;

c) personat kontakt për çdo institucion hedhin të dhënat për praktikantët që realizuan me sukses programin, në platformën e ngritur nga DAP-i;

d) MASR-ja harton formatin e certifikatës për praktikantët që kanë zhvilluar me sukses programin.

URDHËR

Nr. 18, datë 17.1.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, “SAADI”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 3 dhe 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”; të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik të arsimit të mesëm të lartë, “SAADP”, Tiranë, licencuar me urdhrin nr. 361, datë 1.12.2000, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, të ndryshuar me urdhrin nr. 360, datë 5.11.2009.

2. Institucioni arsimor jopublik “SAADP”, Tiranë, ka për detyrë:

a) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur që mund të ketë ndaj tyre;

b) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

c) të vërë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

d) të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri;

e) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik “SAADP”, Tiranë;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe, më tej, të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor jopublik.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit

Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave sipas këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 361, datë 1.12.2000, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, i ndryshuar me urdhrin nr. 360, datë 5.11.2009, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor jopublik “SAADP”, Tiranë dhe Fondacioni “RUMP”, përfaqësuar nga z. Seyed Amirhossein Asghari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

VENDIM
Nr. 2, datë 17.1.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR FONDIN E
NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
DHE PROCEDURAVE PËR
ADMINISTRIMIN E TIJ”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 71, nenit 75, pikat 1 dhe 2, nenit 76, pika 2, si dhe të nenit 87, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurave për



administrimin e tij”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 56, datë 3.10.2017, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 8, shtohet pika 3, sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“3. Për qëllime të përlogaritjes së kontributit vjetor në përputhje me këtë nen, bankat raportojnë brenda muajit shtator të çdo viti, të dhënat mbi aktivet dhe kapitalin rregullator, sipas pasqyrave financiare të audituara të vitit paraardhës, në përputhje me aneksin 1 të kësaj rregulloreje.”.

b) Në nenin 10, pika 3, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

“3. Urdhri bëhet me shkresë zyrtare me postë të regjistruar brenda muajit mars të çdo viti kalendarik.”.

c) Në nenin 18, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

“1. ASD-ja raporton çdo tre muaj pranë Bankës së Shqipërisë mbi veprimtarinë investuese, përbërjen e portofolit të mjeteve financiare dhe gjendjen e “Fondit të ndërhyrjes së

jashtëzakonshme”, si dhe çdo vit, mbi veprimtarinë vjetore të investimit. Raportimi i gjendjes së “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” në Sistemin Elektronik Raportues Rregullator – ERRS, bëhet brenda datës 15 të muajve maj, gusht, nëntor të çdo viti për të dhënat tremujore dhe, brenda datës 7 mars për pasqyrat financiare vjetore të audituara, në përputhje me aneksin 2 të kësaj rregulloreje.”.

d) Në aneks të rregullores shtohet përmbajtja e mëposhtme:

ANEKS 1
TREGUESIT NGA BANKAT PËR
LLOGARITJEN E FONDIT TË
NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Tabela 1. Aktivet dhe kapitali rregullator

Nr.	Zërat	Vlera në lek
1	Totali i aktiveve	
2	Kapitali rregullator	

ANEKS 2
TREGUESIT NGA ASD PËR FONDIN E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Tabela 2. Pasqyra e pozicionit financiar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

Kodi	Zërat	Vlera në lek
1	Aktivet	
1.1	Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	
1.2	Letra me vlerë të mbajtura për të mbledhur flukse monetare, neto	
1.3	Letra me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse	
1.4	Aktive të tjera neto	
	Totali i aktiveve	
2	Detyrimet	
2.1	Detyrime të tjera	
	Totali i detyrimeve	

Tabela 3. Aktivet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

Kodi	Zërat	Vlera në lek
1	Totali i të ardhurave përmblendhëse	
2	Teprica neto e periudhës	
3	Totali i aktiveve neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme	



Tabela 4. Pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve, dhe e të ardhurave përmblendhëse të Fondit të Ndërhijes së Jashtëzakonshme

Kodi	Zërat	Vlera në lek
1	Të ardhurat	
1.1	Të ardhura nga kontributi vjetor	
1.2	Të ardhura nga veprimtaria e investimit	
1.3	Të ardhura të tjera	
1.4	Të ardhura nga përkthimi në monedhë të huaj	
	Totali i të ardhurave	
2	Shpenzimet financiare	
2.1	Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj (-)	
2.2	Shpenzime financiare/komisione (-)	
2.3	Totali i shpenzimeve financiare	
3	Shpenzimet operative	
3.1	Shpenzime operative nga aktiviteti (-)	
3.2	Shpenzime provigjioni për aktivet financiare (-)	
3.3	Shpenzime të tjera (-)	
	Totali i shpenzimeve operative	
4	Teprica neto nga veprimtaria	
5	Të ardhura të tjera përmblendhëse	
5.1	Ndryshime në vlerën e tregut të instrumenteve financiare	
6	Totali i të ardhurave të tjera përmblendhëse	

Tabela 5. Pasqyra e rrjedhës së parasë së Fondit të Ndërhijes së Jashtëzakonshme

Kodi	Zërat	Vlera në lekë
1	Aktiviteti operativ	
1.1	Teprica e fondeve	
1.2	Rregullime për:	
1.2.1	Interes i përlogaritur për investime në LV	
1.3	Provigjioni i aktiveve financiare	
1.4	Ndryshime në aktive dhe detyrime operative	
1.4.1	Aktive të tjera	
1.4.2	Detyrime të tjera	
	Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ	
2	Aktiviteti investues	
2.1	Blerja e letrave me vlerë	
	Rrjedhja e parasë nga aktiviteti investues	
3	Rrjedhja neto e parasë dhe ekuivalentët e saj	
3.1	Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim	
3.2	Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre në fund	

Tabela 6. Pasqyra e ndryshimeve në Fondin e Ndërhijes së Jashtëzakonshme

Kodi	Zërat	Vlera në lekë
1	Aktivitet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhijes së Jashtëzakonshme në fillim të periudhës	
2	Totali i të ardhurave përmblendhëse për vitin	
3	Aktivitet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhijes së Jashtëzakonshme në fund të periudhës	
4	Teprica neto nga veprimtaria për periudhën	
5	Aktivitet neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhijes së Jashtëzakonshme	



2. Përfshirja, për vitin 2020, formula e përlogaritjes së peshës së detyrimeve të bankave e përcaktuar në nenin 8, pika 2, të rregullores, “Për Fondin e Ndërhijes së Jashtëzakonshme dhe procedurave për administrimin e tij”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 56, datë 3.10.2017, ndryshon si në vijim:

“Pesha e bankës_n=Aktivet e bankës_{n-2}/(Totali i aktiveve_{n-2}-Aktivet e ish-Bankës së Kreditit të Shqipërisë_{n-2})”.

3. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen Departamenti i Ndërhijes së Jashtëzakonshme, Departamenti i Statistikave Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko**

KËRKESË

Nr.810/1, datë 21.1.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, për pasurinë e paluajtshme pronë private, që preket nga projekti “Sistemim rrugësh, blloku Goricë”, Bashkia Pogradec.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi kërkohet që të vihen në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM nr.89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimi është 482,586 (katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI:

“Sistemim rrugësh, blloku Goricë”, Bashkia Pogradec
Çmimi për pasurinë truall, sipas vendimit nr.89, datë 3.2.2016

Nr.	Emër, atësi mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP- ja
1	Adrian Shaban Haxhillari	8582	14/68	Truall	m ²	46	10491	482,586	Certifikatë pronësie
Shuma totale e shpronësimit						46		482,586	

**KËRKESË****Nr. 811/1, datë 21.1.2020****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Arbrit” (shtesa).

Subjekti kërkues i këtij projekti është ARRSH.

Me anë të këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16,808,960 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËTIMI I SEGMENTIN RRUGOR “RRUGA E ARBRIT” SHITESA

N/R	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË							Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. Pas.	Lloji Pas.	Sip. Totale (m2)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"		Vlera Totale (lekë)		
								Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)		Vlera (lekë)	
1	HAJDAR	AVDULLA	JANAKU	1124	1123	ARE	329	329	448					147392	Konf. ASHK
2	HAJDAR	ABDULLA	JAMAKU	1124	1127	PEMTORE	514	514	448					230272	Konf. ASHK
3	HAJDAR	ABDULLA	JAMAKU	1124	1126	ARE	923	923	448					413504	Konf. ASHK
4	REXHEP	REXHEP	JAMAKU	1124	1115	ARE	664	622	448					278656	Konf. ASHK
5	RAMAZAN	ALI	META	1124	1160	ARE	1706	644	448					288512	Konf. ASHK
6	FIQIRI	QAMIL	META	1124	1163	ARE	1353	90	448					40320	Konf. ASHK
7	XHELAL	ALI	META	1124	1161	ARE	1794	549	448					245952	Konf. ASHK
8	XHEMAL	QAMIL	META	1124	1162	ARE	1537	338	448					151424	Konf. ASHK
9	BAJRAM	OSMAN	META	1124	1164	ARE	4210	13	448					5824	Konf. ASHK
10	SHABAN	SALI	DERVISHI	1124	1165	ARE	5255	2219	448					994112	Konf. ASHK
11	LUAN	HYSEN	STAFI	3876	258/2	ARE	1241.8	30	448					13440	Konf. ASHK
12	ABAZ	RESHEF	LILA	1124	1159	ARE	1263	476	448					213248	Konf. ASHK
13	MUSTAFA	SALI	LILA	1124	1184	ARE	1099	1099	448					492352	Konf. ASHK
14	MUSTAFA	SALI	LILA	1124	1183	ARE	4190	1145	448					512960	Konf. ASHK
15	ABAZ	RESHEF	LILA	1124	1181	ARE	2180	1992	448					892416	Konf. ASHK
16	RABIE	ISUF	LILA	1124	1182	ARE	4190	3782	448					1694336	Konf. ASHK
17	ELMAZ	ISUF	LILA	1124	1178/1	ARE	3135	2359	448					1056832	Konf. ASHK
18	GËZIM	ISUF	LILA	1124	1178/2	ARE	3134	160	448					71680	Konf. ASHK
19	SELIM	SALI	LILA	1124	1152	ARE	10247	4969	448					2226112	Konf. ASHK
20	AVDI	HAJDAR	JAMAKU	1124	1146	ARE	1605	439	448					196672	Konf. ASHK
21	HALIL	SALI	LILA	1124	1136	ARE	4932	1273	448					570304	Konf. ASHK
22	MEHMET	ABDYL	JAMAKU	1124	1144	ARE	3194	556	448					249088	Konf. ASHK
23	REXHEP	REXHEP	JAMAKU	1124	1148	ARE	5081	3095	448					1386560	Konf. ASHK
24	XHEVAHIR	ISUF	LILA	1124	1172	ARE	498	498	448					223104	Konf. ASHK
25	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1170	ARE	435	435	448					194880	Konf. ASHK
26	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1168	ARE	1476	885	448					396480	Konf. ASHK
27	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1169	ARE	629	129	448					57792	Konf. ASHK
28	XHEVAHIR	ISUF	LILA	1124	1171	ARE	1490	172	448					77056	Konf. ASHK
29	XHEVAHIR	ISUF	LILA	1124	1173	ARE	8514	174	448					77952	Konf. ASHK
30	NURI	BESHIR	HOXHA	1124	1174	ARE	5919	2523	448					1130304	Konf. ASHK
31	MUSTAFA	SALI	LILA	1124	1176	ARE	3808	1639	448					734272	Konf. ASHK
32	ABAZ	RESHEF	LILA	1124	1179	ARE	680	528	448					236544	Konf. ASHK



33	HALIL	SALI	LILA	1124	1135	PEMTORE	594	594	448					266112	Konf. ASHK
34	HALIL	SALI	LILA	1124	1138	ARE	420	310	448					138880	Konf. ASHK
35	REXHEP	REXHEP	JAMAKU	1124	1129	PEMTORE	233	233	448					104384	Konf. ASHK
36	AVDI	HAJDAR	JAMAKU	1124	1128	ARE	326	326	448					146048	Konf. ASHK
37	HAMZA	SUL	NASUFI	3876	316/3	ARE	320	233	448					104384	Konf. ASHK
38	ALI	BEQIR	HUSHA	3876	250/2	ARE	1460	678	448					303744	Konf. ASHK
39	HAXHI	SUL	NASUFI	3876	316/13	ARE	1400	374	448					167552	Konf. ASHK
40	RAMAZAN	SHABAN	AHMETI	3876	316/10	ARE	1090	173	448					77504	Konf. ASHK Kufizim mbi pasurine
	SHUMA							37520						16808960	



KËRKESË
Nr.812, datë 21.1.2020

PËR SHPRONËSIMI PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit “truall” dhe “ndërtesë banimi” që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi ish-parkut Kuçovë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Kuçovë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe

personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara. Lutemi pronarët dhe personat që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 48,481,141 (dyzet e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e dyzet e një) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA PARAPRAKE E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I ISH-PARKUT KUÇOVË”

Nr.	Vendodhja	Emri, Mbiemri i pronarit	Të dhënat e pasurisë				Lloji i pronës	Lloji i pronës		Sipërfaqe për shpronësim (m2)	Çmimi i truall lekë/m2	Vlera në lekë për truall	Sipërfaqe për shpronësim (m2)		Çmimi mesatar banesës /apartamentit nga ZRPP 36000 minus vlerën e tokës 2040	Vlera për ndërtesë	Objekte të tjera	Vlera totale për shpronësim (lekë)	Shënim
			Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Volumi	Faqe	Tokë	Ndërtesë		Tokë			Ndërtesë		36000-2040				
							Truall	Banim	Shërbim	Truall			Banim	Shërbim					
1	KUCOVË	Vasil Simon Gjika dhe Katerina Leksi Gjika	2310	6/159+1-2	23	117		55					55		33960	1,867,800		1,867,800	
2	KUCOVË	Altin Avdyli Malaj	2310	6/561	41	130	160	55	105	160	2040	326,400	55	105	33960	6,810,076		7,136,476	
3	KUCOVË	Arben Izet Tabaku	2310	6/194-ND	18	46	-		50	-				50		1,008,088		1,008,088	
4	KUCOVË	Arjan Haxhem Qato	2310	6/196	26	219	239		115	239	2040	487,560		115		1,639,394		2,126,954	
5	KUCOVË	Adrian Vasil Shuka, Denada Vasil Shuka dhe Sokol Vasil Shuka	2310	6/156-ND2	17	213	-		2145	-						5,785,479		5,785,479	
6	KUCOVË	Donika Kastriot Tafili dhe Elton Shpëtim Tafili	2310	6/207	42	2	134	14.6	18.5	134	2040	273,360	14.6	18.5		1,520,088		1,793,448	
7	KUCOVË	Ligor Sifit Rogozi	2310	6/168-ND	25	117	-		61	-				61		954,390		954,390	urdhër kufizimi
8	KUCOVË	Murat Ali Benja	2310	6/314	29	64	2713		1025	2713	2040	5,534,520		1025		11,626,692	8,440,909	25,602,121	urdhër kufizimi
9	KUCOVË	Vangjel Jani Pietri	2310	6/197	26	240	173		65.6	65.6	2040	133,824		65.6		1,575,239		1,709,063	
10	KUCOVË	Vasil Simon Gjika	2310	6/209	27	75	94		18	94	2040	191,760		18		305,562		497,322	
TOTALI										3405.6		6,947,424				33,092,808	8,440,909	48,481,141	



**KORRIGJIM GABIMI
NË VENDIMIN NR.112, DATË 8.7.2016
“PËR PËRCAKTIMIN E TË
LICENCUARIT TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR TREGUN E
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR
USHTRIMIN E DETYRIMIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL”, BOTUAR NË
FLETOREN ZYRTARE NR.139, DATË
27.7.2016**

**KUSHTET PËR TË LICENCUARIN E
NGARKUAR ME DETYRIMIN E
SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR TREGUN
E ENERGJISË ELEKTRIKE NË
SHQIPËRI**

**Neni 1
Objekti**

Kushtet e parashikuara për të ngarkuarin me detyrimin e shërbimit universal në këtë akt nënligjor në mbështetje të parashikimeve të nenit 83, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” kanë për qëllim të sigurojnë shërbimin universal të furnizimit me energji elektrike nga i licencuari i ngarkuar me këtë detyrim.

Shërbimi Universal i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Universal, i cili siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për klientët që përfitojnë nga shërbimi universal në Republikën e Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga rritjet e paarsyetuara të çmimit duke arritur hapjen e plotë të tregut të energjisë elektrike siç parashikuar në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

**Neni 2
Kushtet**

Të gjithë termat e përdorur në vijim kanë kuptimin e përshkruar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

**Neni 3
Furnizuesi i shërbimit universal**

1. Kompanisë OSHEE sh.a./ FSHU në rolin e furnizuesit të energjisë elektrike i vendoset detyrimi i shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të nenit 83, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. Duke qenë i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit si pjesë e detyrimit të shërbimit publik, OSHEE sh.a./ FSHU në funksionin e furnizuesit është i detyruar të furnizojë klientët fundorë sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

3. Në përputhje me detyrimet e Shqipërisë që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe, përcaktimet e nenit 72, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016 OSHEE sh.a./ FSHU duhet të ndajë funksionalisht, financiarisht dhe ligjërish, aktivitetin e Furnizimit nga ai i Shpërndarjes së energjisë elektrike.

**Neni 4
Detyrimet e shërbimit publik**

1. Për të siguruar shërbimin universal, në përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij akti nënligjor vendosen detyrimet e mëposhtme të shërbimit publik mbi kompanitë e tregut të energjisë elektrike, si masa mbrojtëse për interesat e përgjithshme publike:

a) furnizim me çmim të rregulluar e energjisë elektrike nga KESH sh.a. dhe blerja e saj nga OSHEE sipas nenit 5 të këtij akti nënligjor;

Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.

b) furnizimin me çmim të rregulluar me energji elektrike për kategoritë e klientëve të përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” (neni 6 i këtij akti nënligjor).



c) për sasinë e energjisë që nuk mund të sigurohet nga KESH sh.a. Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar

d). Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet t'u ofrojë klientëve të drejtën e kontratave standarde, të përgatitura në bazë të kushteve standarde të furnizimit me energji elektrike, të miratuara nga ERE, në përputhje me nenin 84, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.

2. Brenda 30 ditëve kalendarike pasi janë miratuar kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri, këto detyrime të shërbimit publik/ shërbimit universal do të jenë pjesë integrale e licencave përkatëse të kompanive në fjalë të energjisë elektrike në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 5

Furnizimi energjisë elektrike me çmim të rregulluar

1. Çmimi i energjisë elektrike për sasinë e ofruara nga KESH sh.a. për OSHEE sh.a./ FSHU do të jetë i rregulluar në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. ERE do të monitorojë vazhdimisht ecurinë e çmimit dhe të informojë Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri (AK) për çdo të dhënë për abuzim në treg.

2. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH) duhet t'i shesë dhe i ngarkuari me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit si pjesë e detyrimit të shërbimit publik (OSHEE sh.a./ FSHU) duhet të blejë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike të prodhuar.

3. Para se të krijohet tregu i organizuar, OSHEE sh.a./ FSHU blen energjinë elektrike të kërkuar nga klientët duke tejkalluar vëllimet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni nga prodhuesit dhe tregtarët përveç KESH sh.a. në mënyrë transparente, jodiskriminuese, të bazuar të tregu dhe sipas Rregullave të miratuara nga ERE.

Neni 6

Rregullimi i furnizimit me energji elektrike

1. Si furnizues i shërbimit universal, OSHEE sh.a. FSHU është e detyruar të furnizojë kategoritë e klientëve të përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” sipas kushteve dhe çmimeve të rregulluara në këtë akt nënligjor dhe në metodologjinë përkatëse të llogaritjes së çmimit për furnizimin universal në të gjithë territorin e Shqipërisë.

2. Furnizuesi i shërbimit universal duhet t'u ofrojë klientëve të cilët kanë të drejtën e shërbimit universal, shërbimin e furnizimit konform kontratës standarde të furnizimit të të miratuar nga ERE në përputhje me nenin 84, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve. Furnizuesi nuk duhet t'u devijojë kontratave standarde (ose tip) dhe duhet të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet sipas kompetencave të tyre të plota. Kontrata e furnizimit me energji elektrike për kategoritë e përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” mund të përfundojë në rastet e parashikuara qartë në aktet nënligjore dhe/ose në kontratat.

3. Kontratat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni duhet të përcaktojnë detyrimin e klientit për të paguar për energjinë elektrike të furnizuar në çmime të miratuara nga ERE, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 20, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 7 të këtij akti nënligjor.

4. Kontratat e referuara në paragrafin 2 të këtij neni, përveç kushteve të veçanta të përcaktuara në nenin 80, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, duhet të përcaktojnë detyrimet e furnizuesit të shërbimit universal si më poshtë:

a) të informojë klientët për të drejtat dhe kushtet që të furnizohet sipas shërbimeve universale;

b) të informojë klientët për termat dhe kushtet e furnizimit dhe çmimit të energjisë elektrike dhe t'i informojë që kanë të drejtën të zgjedhin një furnizues tjetër;

c) furnizimin me energji elektrike sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë akt nënligjor;

d) të informojë klientët mbi masat për të kryer detyrimet e papaguara;



e) furnizimi i klientëve në nevojë sipas kushteve të përcaktuara në ligjin për sektorin e energjisë elektrike dhe legjislacionit përkatës në vend;

f) të publikojë në faqen e internetit çmimet e furnizimit të miratuara nga ERE.

5. Për aq kohë sa nuk është përcaktuar nga ky akt nënligjor, shërbimet e furnizimit të energjisë elektrike për kategoritë e përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” duhet të parashikohen sipas Rregullave të Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, të miratuar nga ERE sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në “Ligjin e sektorit të energjisë elektrike”.

6. Furnizuesi i shërbimit universal duhet të mbajë një regjistër për numrin e klientëve të furnizuar prej tij dhe një regjistër të posaçëm me çdo të dhënë të këtyre klientëve i cili duhet të përditësohet rregullisht dhe duhet t’i komunikohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ERE. Në faqen e internetit të ERE do të publikohen të dhënat që nuk shkelin parashikimet e ligjit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale” nr. 9887, datë 10.3.2008, të ndryshuar.

Neni 7

Çmimi i rregulluar për furnizimin e klientëve të fundorë nga furnizuesi i shërbimit universal

1. Çmimi i energjisë elektrike i vendosur nga furnizuesi i shërbimit universal për kategoritë e klientëve të përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” caktohet nga ERE në përputhje me nenin 85, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe metodologjitë e miratuara nga ERE.

2. Çmimi i energjisë elektrike me të cilën Furnizuesi Universal shet energjinë elektrike te klientë që përfitojnë nga ky shërbim, do të përfshijë koston e arsyetuar të furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë koston e blerjes së energjisë nga prodhuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, koston e blerjes së energjisë së prodhuar nga burime të rinovueshme sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për burimet e rinovueshme, koston e blerjes së energjisë në tregun e parregulluar, si dhe tarifën e shërbimit të rrjetit të

transmetimit dhe shpërndarjes, si dhe koston e furnizimit.

3. ERE duhet të publikojë Metodologjinë për llogaritjen dhe analizimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë të shërbimit universal të energjisë elektrike.

Neni 8

Pagesa për të siguruar shërbimin publik

1. Deri në datën 31 dhjetor 2017, OSHEE sh.a./ FSHU, duhet të marrë kompensimin për sigurimin e shërbimit universal, nga buxheti i shtetit i alokuar për të siguruar shërbimin universal, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe bazuar në nenin 47 (8), të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. OSHEE sh.a./ FSHU ka të drejtën e kompensimit nga buxheti i shtetit deri në atë masë kur mund të provojë që çmimi i rregulluar i furnizimit me energji elektrike është më i ulët se koston dhe shpenzimet e bëra për blerjen dhe furnizimin me energji elektrike për kategoritë e klientëve të përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas nenit 7 të këtij akti nënligjor.

3. Ky kompensim duhet të miratohet çdo vit me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave sipas nenit 47(8), të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregullores për kushtet e përgjithshme për të vendosur detyrimet e shërbimit publik në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe shqyrtimit vjetor të rregullimit të çmimit nga ERE sipas nenit 85, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 9

Shfuqizimi i çmimit të rregulluar për klientët fundorë

1. Para datës 31 dhjetor 2017, ERE do të shqyrtojë mundësinë për të mbajtur çmimin e rregulluar si një masë të nevojshme për të siguruar shërbimin universal për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, duke siguruar që kushtet e tregut të zhvillohen në atë mënyrë që klientët të cilëve iu është dhënë e drejta për shërbimin universal, mund ta blejnë energjinë elektrike në treg me çmime të arsyeshme të parregulluara.



2. ERE mund të vendosë përsëri detyrimin e shërbimit publik për të siguruar shërbim universal me çmime të rregulluara për kategoritë e klientëve të përcaktuara në nenin 109, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, që përfitojnë nga shërbimi universal në të ardhmen, duke provuar që kjo masë është e nevojshme dhe e arsyetuar.

Neni 10

Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE, duke vepruar brenda kompetencave të saj duhet të sigurojë monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e këtyre kushteve për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri siç parashikuar në këtë akt nënligjor.

2. Të licencuarit të cilët shkelin kushtet e përcaktuara si më sipër, do të jenë përgjegjës sipas dispozitave të nenit 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në Shqipëri.

Neni 11

Publikimi

Vendimi për përcaktimin e OSHEE sh.a/ FSHU si furnizues i besuar për sigurimin e shërbimit universal botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe duhet të vihet në

dispozicion të publikut në faqen e internetit dhe qendrën e informacionit të klientëve të OSHEE sh.a/ FSHU si edhe dhe në faqen e internetit të ERE.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo akt nënligjor hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 13

Njoftimi i Entit Rregullator të Energjisë

ERE do të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për miratimin e kushteve për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri dhe çdo ndryshim të tyre.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2019-5963) 1595, datë 24.10.2019, vendosi shpalljen të zhdukur në datën 12.10.1996, të shtetasit Muhamed Virjoni, i biri i Besimit dhe i Xhemailes, i datëlindjes 15.6.1956, lindur në Tiranë dhe banues në Durrës.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 756 lekë